


Reagimi i parë i nobelistes së sapozgjedhur në letërsi, Han Kang kur u telefonua nga Jenny Rydén, korrespondenti i Komitetit të "Nobelit"

HAN KANG:

Jam kaq e befasuar dhe e nderuar

Bisedoi: Jenny Rydén



SHËNIME TË KURATORIT PËR EKSPOZITËN
E FUNDIT TË PIKTORIT TË NJOHUR

“Viti Zero” i Gazmend Lekës

Nga Ermir Hoxha

(fq. 6)

Prej disa vitesh, Leka e ka drejtuar vëmendjen tonë drejt atyre përthyerjeve tektonike, sa shpirtërore, aq edhe materiale. Si gjithnjë, në atë stacion sezonal të kalendarit vjetor. Ndërsa ka bërë këtë, piktura e tij është bërë gjithnjë e më e vyer, konsoliduar mirëfilli si vlerë sipërore.

Mungesa e padurueshme e stendës “Albania” në panairin e Frankfurtit

Nga Andreas Dushi (fq. 3)

SHËNIME MBI LIBRAT

POLIFONIA E MENDIMIT NË KRIJIMTARINË E NATASHA LAKOS

Nga Majlinda Rama (fq. 5)

Lexim letrar, gjuhësor e stilistik i romanit “Një dashuri dhe shtatë faje” të Rexhep Qosjes

Nga Shefkije Islamaj (fq. 8)

90-vjetori i lindjes së studiuesit të shquar Dilaver Kurti

Një jetë në kërkim të visareve të kulturës popullore

Nga Vlash Prendi (fq. 14)

Monografia e Anton Nikë Berishës “Maksimilian Lamberci për Letërsinë Shqipe”

MAKSIMILIAN LAMBERCI NJOHËS DHE STUDIUESI SHQUAR I LETËRSISË SHQIPE

Nga Msc. Arsim Halili (fq. 5)

“Ankesat e guvernatorit të parë të Tomisit për Ovidin” dhe “Si mund të vrasim një poet”

RILEXIM I DY POEZIVE TË RUDOLF MARKUT

Nga Enver S. Morina (fq. 5)



In memoriam

Skënder Karriqi-njeriu dhe studiuesi që do të kujtohet

Nga Qazim Shehu (fq. 15)

Gjashtë vite më parë u nda nga jeta poeti i shquar

REQUIEM PËR FATOS ARAPIN

Nga Prof. Dr. Bardhosh Gaçe (fq. 12)

Mes vdekjes, frikës dhe absurdit në letërsinë e Dino Buzzati-t

Nga Jola Tasellari (fq. 22)



BIBLIOTEKË

Ismail Kadare (fq. 14)

Nudo

Ilir Paja (fq. 16)

Një lutje vjeshte

Preng Maca (fq. 18)

Drita brenda nesh

Arben Mexsi (fq. 20)

Karikatura e së shtunës

Rudina Çupi (fq. 21)

Doemos

Ylli Pango (fq. 23)

Poeti i vyejtun Barbun

Tomas Tranströmer (fq. 23)

Shubertiana

Filozofia dhe teologjia e Shën Nënës Terezë sipas Don Lush Gjergjit

Nga Prof. Dr. Skënder Asani (fq. 11)

Ernest Baba - Fituesi i konkursit ndërkombëtar të fotografisë “Fokus Award 2024”

Nga Qerim Vrioni (fq. 13)

Laureatja e çmimit “Nobel” për 2024, Han Kang e merr lajmin kur sapo ka përfunduar darkën bashkë me të birin në shtëpinë e saj në Seul. Në këtë intervistë, përsiat mbi të qenurit laureatja e parë nga Korea e Jugut si dhe flet se si shkrimtarët në tërësi e kanë ndikuar: “Gjithë përpjekjet dhe fuqia e tyre kanë qenë frymëzimi im.”

Han Kang po ashtu flet për procesin e të shkruarit të suksesit ndërkombëtar “Vegjetariania” dhe sugjeron librin e saj më të ri *We do not part* për gjithkënd që ka kureshtje të fillojë të lexojë librat e saj.

Han Kang: Përshëndetje?

Jenny Rydén: Përshëndetje, Han Kang është?

HK: Po.

JR: Unë jam Jenny Rydén. Ju telefonoj nga Çmimi Nobel.

HK: Po. Shumë kënaqësi të flas me ju.

JR: Shumë kënaqësi dhe për mua. Më lejoni, ju lutem, t’ju shpreh më së pari përgëzimet e mija.

HK: Faleminderit. Shumë faleminderit.

JR: Si ndihesh në këtë çast?

HK: Jam shumë e befasuar dhe absolutisht, jam e nderuar.

JR: Si e morët vesh për çmimin?

HK: Më telefonoi dikush dhe më tregoi për këtë lajm, ndaj sigurisht, isha e surprizuar. Dhe, sapo përfundova darkën me tim bir dhe në Kore, ora është tetë e mbrëmjes. Kështu, po, është një mbrëmje tejet e paqte. Isha vërtetë e befasuar.

JR: Dhe jeni në shtëpinë tuaj në Seul?

HK: Po, jam në shtëpi, në Seul.

JR: Dhe si e keni çuar ditën sot?

HK: Sot? Sot nuk kam punuar, vetëm kam lexuar pak dhe kam dalë për një ecje. Ishte një lloj dite krejt e lehtë për mua.

JR: Pra the se je me tët bir. Si reagoi ai për lajmin?

HK: Edhe im bir ishte i surprizuar,

Reagimi i parë i nobelistes së sapozgjedhur në letërsi, Han Kang kur u telefonua nga Jenny Rydén, korrespondenti i Komitetit të “Nobelit”

HAN KANG:

Jam kaq e befasuar dhe e nderuar

Bisedoi: Jenny Rydén

Han Kang u lind në 1970 në qytetin Koreano Jugor të Gvangju përpara se në moshën nëntëvjeçare të shpërngulej me familjen e saj në Seul. Vjen nga një sfond letrar, me babanë e saj romancier të njohur. Së bashku me të shkruarin, ajo gjithashtu i është përkushtuar artit dhe muzikës, që është e reflektuar përmes gjithë krijimit të saj letrar.

Zbulimi kryesor ndërkombëtar i Han Kang erdhi me romanin “Vegjetariania”. I shkruar në tri pjesë, libri portretizon pasojat e dhunshme që vijnë kur protagonistja e tij Yeong-hye refuzon t’u nënshtrohet normave të të ushqyerit. Vendimi i saj për të mos ngrënë mish përballet me disa reagimi krejt të ndryshme. Sjellja e saj refuzohet me forcë prej bashkëshortit të saj dhe babait autoritarin, dhe ajo shfrytëzohet erotikisht dhe estetikut nga kunati i saj, një artist videosh i cili fiksohet pas trupit të saj pasiv. Në fund ajo shtrohet në një klinikë psikiatrike, ku e motra tenton ta shpëtojë e ta kthejë në një jetë ‘normale’. Gjithsesi, Yeong-hye zhytet gjithnjë e më shumë në një gjendje të ngjashme me psikozën të shprehur përmes ‘pemëve të përflakura’, një simbol për një mbretëri bimësh që është aq tërheqës sa është i rrezikshëm.

por s’është se kishim shumë kohë ta flisnim. Ishim të befasuar dhe kaq është e gjitha.

JR: E imagjinoj. Çfarë do të thotë të marrësh Çmimin Nobel në letërsi?

HK: Po, jam e nderuar dhe vërtetë e vlerësoj mbështetjen, mbështetjen e çmimit. Thjesht e vlerësoj.

JR: Ju jeni e para laureate në letërsi nga Korea e Jugut. Si ndiheni për këtë?

HK: Po. Jam rritur mes librash, e di?, ndaj qysh kur kam qenë fëmijë, jam rritur me libra në gjuhën koreane dhe të përkthyer. Kështu që mund të them se jam rritur me letërsi koreane, me

të cilën ndihem shumë pranë. Kështu shpresoj që ky lajm të jetë i këndshëm për lexuesit e letërsisë koreane si dhe për miqtë e mi shkrimtarë.

JR: Thatë se vini nga një sfond letrar. Cilët autorë kanë qenë burimi juaj më i rëndësishëm i frymëzimit?

HK: Për mua, qysh se kam qenë e vogël, të gjithë autorët kanë qenë së bashku. Ata janë në kërkim të kuptimit të jetës. Ndonjëherë janë të humbur dhe ndonjëherë, të vendosur dhe gjithë përpjekjet e tyre bashkë me gjithë fuqinë e tyre kanë qenë frymëzimi im. Ndaj e kam shumë të vështirë të zgjedh ndonjë

emër të frymëzuesve. E kam shumë të vështirë.

JR: Kam lexuar se autorja suedeze Astrid Lindgren ka qenë një burim frymëzimi për ju, po?

HK: Ashtu është. Kur isha e vogël, e kisha shumë përzemër librin e saj *Vëllezërit Zemërluanë*. Dhe e kisha vërtetë përzemër atë libër, por nuk mund të them se ka qenë e vetmja autore që më ka frymëzuar gjatë fëmijërisë. Kur e lexoj atë libër, *Vëllezërit Zemërluanë*, mund ta lidh me pyetjet e mia rreth njerëzve ose jetës dhe vdekje.

JR: Për dikë që sa po e zbulon punën tuaj, nga do t’i sugjeronit t’ia fillonte?

HK: Mes librave të mi? Mendoj se çdo shkrimtar do të pëlqente librin e tij të fundit. Kështu, libri im i fundit është *We do not part*, ose quhet me emrin *Do not bid Farewell* apo *Impossible Goodbyes*. Shpresoj që ky libër të mund të jetë një fillim. Edhe *Human Acts* është i lidhur drejtpërdrejt me këtë libër. Pastaj *The White Book* që është shumë personal për mua, ngase është goxha autobiografik. Dhe atëherë *Vegjetariania*. Por ndjej se fillimi mund të jetë *We Do Not Part*.

JR: Për një audiencë ndërkombëtare, *Vegjetariania* ndoshta është më i mirënjohuri. Çfarë do të thonit për domethënien e këtij romani për ju?

HK: E kam shkruar përgjatë tre vjetëve dhe ato tre vjet kanë qenë disi të vështirë për mua, për shumë arsye. Kështu mendoj se po vuaja të gjeja imazhet e kësaj protagonisteje, njerëzve që e rrethojnë dhe imazhin e pemës dhe të dritës së diellit dhe të gjithçkaje që ishte aq gjallë përgjatë atyre tre vitesh.

JR: Edhe pak dhe do t’ju lë të ikni. Keni ndonjë ide se si do ta festoni këtë çmim Nobel?


HK: Pas kësaj telefonate, do të doja të pija një çaj – unë nuk pi – Do të pi një çaj me tim bir dhe do të festoj qetësisht sonte.

JR: Shumë mirë. Shumë përgëzime, sërish. Shumë faleminderit.

HK: Faleminderit.

JR: Në rregull, mirë u pafshim.

HK: Kujdesuni për veten. Pafshim’.



“Dal e transformuar dhimbshëm nga të gjithë librat e Han Kang”: Lexuesit e Han Kang mbi romanin e saj “Vegjetaria”

The Guardian pyeti disa nga lexuesit e nobelistes Han Kang se çfarë mendonin për veprat e saj. Në vijim, një pjesë e përshtypjeve që u ka lënë atyre romani “Vegjetaria”.

“Dal e transformuar dhimbshëm nga të gjithë librat e Han Kang”

Lexova më së pari “Vegjetaria”. Mu duk subversiv, poetik, i errët, i dhunshëm dhe shumë i vërtetë. Ishte diçka si asgjë tjetër çfarë kisha lexuar më para dhe duke sikur qendronte në një ligë më vete.

Është një libër thellësisht feminist, thjesht ngase është një libër thellësisht human që merret me një grua e cila shkëputet prej gjithçkaje të njohur ndonjëherë për të: familjes, bashkëshortit, gjithë shoqërisë. Ishte një lexim transformues.

“Human Acts” ishte tramuatizues në menjëhershmerinë e vet – ishte rrëqethës dhe i dhunshëm dhe ndiheshja sikur isha aty, me ato studentë (gjatë protestave studentore të 1980). Dal e transformuar dhimbshëm nga të gjithë librat e Han Kang

Duke folur për të me këdo që dëshirontë të dëgjonte, isha vërtetë shumë e emocionuar të shihja që fitonte gjithë këtë njohje. Është një zë unik që meriton të dëgjohet kudo në botë.

Mia Kovačić, 34 vjeç, Drejtoreshë Komunikimi, Paris

“më bëri të lotoj për fuqinë e mirësisë”

Shkova në Skiathos, Greqi, këtë vit dhe mora “Greek Lessons” me vete. Ia kam rekomanduar kaq shumë njerëzve që atëherë, duke thënë se asgjë nuk ndodh, por gjithçka ndodh... më bëri të lotoj për fuqinë e mirësisë”.

E radhës ishte “Vegjetaria”, të cilën e kisha në raftin e librave prej vitësh. Atë e lexova në trenin për në Londër dhe e përpiva brenda ditës. Thotë gjithçka dhe gjithçka ndodh.

Të shkruarit e saj është magjepsës dhe urgjent dhe i vërtetë. Është një grusht fytyrës dhe jam kaq e lumtur që e kam gjetur veprën e saj.

“më kanë lënë gjithmonë imazhe intensive në mendje”

Veprat e Han Kang ngushëllojnë pikëllimet e historisë dhe shoqërisë bashkëkohore koreane. Jam qetësuar prej tyre dhe jam ndikuar nga rrëfimet e tyre, të cilën më kanë lënë gjithmonë imazhe intensive në mendje dhe më kanë ndikuar në të shkruar dhe të vizatuar. Si errësira e pafundme dhe vetmia të “I do not bid farewell”, apo shpresat e privuara dhe dëshirat e gabuara të “Human Acts”.

Isha duke studiuar në Londër herën e parë që lexova “Vegjetaria”. Kur e përfundova librin, u ndjeva sikur kisha parë një vepër arti vizual bashkëkohor – trupëzoi vizualizimin e fuqishëm të rrëfimit të vet. Më shtrëngoi, fort.

Një prej forcave të mëdha të romaneve të saj është vënia në pah e jetëve të paprekshme të njerëzve të vegjël përmes historisë dhe shoqërisë koreane, pikëllimet shoqërore dhe historike dhe agonitë e tyre që shpesh shpërfillen. Ajo kap zërat, dhe qëndresën, e njerëzve të brishtë – individëve që kanë luftuar për ekzistencën e tyre.

Noah Kim, 33, vizaton ilustrime dhe shkruan tregime të shkurtra për libra fëmijësh, Seul, Korea e Jugut

Pse Han Kang po refuzon të festojë për çmimin “Nobel”?

Të premtën, nëpërmjet të atit, Han Kang ndau me publikun se nuk do ta mbante konferencën e zakonshme për shtyp që të fliste rreth çmimit Nobel. I ati, romancieri Han Seung-Wo shpjegoi zgjedhjen e saj politike. “Ajo tha se me luftrat e tërbuara mes Rusisë dhe Ukrainës, Izraelit dhe Palestinës, me gjithë vdekjet e raportuara çdo ditë, nuk mund të mbajë një konferencë festive,” i tha Seung-Wo reporterëve korean. “Ajo kërkon mirëkuptim për këtë çështje.”

Mungesa e padurueshme e stendës “Albania” në panairin e Frankfurtit

Nga Andreas Dushi

Në datë 16 tetor, gjatë Panairit të Librit në Frankfurt, autori tejet i njohur Yuval Harari pati një diskutim me filozofin japonez Kohei Saito lidhur me sfidat e bashkëkohësisë dhe mënyrën si duhet të përballemi me to. Mes të tjerash, në një përgjigje që u duartroi prej publikut, Saito tha se priste të vinte një kohë kur interneti do të mbushej aq shumë me informacione të pavërteta dhe të pabesueshme, sa që njerëzit natyrshëm do ta braktisnin dhe do t'i riktheheshin kërkimit të informacionit të materialet e shtypura, kryesisht ndër libra. Kjo më kujtoi atë çfarë thotë Umberto Eco në dialogun me Jean-Claude Carrière, botuar së fundmi në shqip nga “Dituria”. Sipas tij, libri është një shpikje e përkryer së cilës nuk ke çfarë t'i ndryshosh, pak a shumë ashtu sikurse rrota. Në një perspektivë të tillë atëherë, te libri si e vetmja siguri për përmbajtje të besueshme, pa asnjë nevojë për shpenzime që t'i përmirësohet trajta apo forma në vetvete, si mund të investohet për t'ia çelur shtegun drejt lexuesit? Përkthime, promovime e të tjera e të tjera përmbledhen nën një strehë të vetme: Panairin e Frankfurtit ku edhe sivjet, për të një-Zot-e-di të satin vit, Shqipëria nuk mori pjesë zyrtarisht me një stendë, paçka se në avionin e nisur nga Tirana me datë 15 tetor ishin disa prej botuesve kryesorë shqiptarë.

Nëpër korridoret e pafundme të Panairit, sheh stendat e të gjitha vendeve, një pjesë me dizajnin e konceptuar sipas tematikave përfaqësuese. Mungojnë, bashkë me ne, Palestina që është në luftë, Koreja e Veriut, Turkmenistani, ca vende të Oqeanisë dhe ndonjë tjetër shtet i vogël sa kopsa e xhepit të këmishës në hartën e kontinentit të vet. Dhe kjo, sa vjen e bëhet më e padurueshme!

Shqipëria, një prej vendeve me mbështetjen më të ulët për përkthimin e letërsisë së saj, as në ato raste kur shtëpi të huaja botuese shprehin dëshirën dhe gatishmërinë për ta botuar një autor shqiptar, nuk ua ofron atyre një hapësirë minimale ku të mund të takohen. Se për t'i përfaqësuar apo promovuar, as nuk ia vlen të diskutohet. Ata që ngrenë dhe ulin sipare eventesh bosh si për nga përmbajtja, ashtu për nga pjesëmarrja, me gjasë të lodhur nga kjo punë mekanike ulje-ngritjesh, as nuk e vrasin mendjen se në ngjarjen më të rëndësishme të librit në botë, aty ku misioni i tyre merr kuptim, tregojnë se në fakt as që ekzistojnë.



Vizatim nga Anastas Kostandini - Taso

Po përse edhe sot vazhdon të ndodhë kjo, në një kohë kur Shqipëria është pjesëmarrëse në panairin turizmi apo kulinarie, mode apo teknologjie? Si ka mundësi që vetëm sektori i librit është i përjashtuar nga strategjitë e shtetit për ndërkombëtarizim? Ç'është ky ngut i pashembullt për t'i ndërprerë rrugën çdo mundësie komunikimi të këtij burimi të sigurt informacioni që Saito thotë se do të mbetet i vetmi?

Kjo mosqenie e Shqipërisë në Panair më kujton një pjesë nga poezia e Kadaresë *Panairi Ndërkombëtar i Librit në Frankfurt*, shkruar më 1981:

Nga të gjitha stendat vetëm njëra ndryshon

*Stendë e Kosovës është bosh.
Kalojnë shovinistët,
Buzëqeshin nën buzë.
Pamja, pa dyshim, i josh.*

Ëndërr e tyre ta shohin Kosovën kështu

*Pa libra, pa art, pa shpirt.
Reporterët erdhën papritur me vrull
Për të filmuar atë shkretë.*

Prej vitësh tani jemi në një situatë krejt tjetër, me Kosovën e pranishme në një hapësirë dinjitoze ku përfaqësohen dhe mirëprehen gjithë autorët e saj bashkë me ne të pastendët sa herë kemi nevojë dhe në të njëjtën kohë, Shqipërinë e 2024 të shfaqur si Kosova e 1981, *pa libra, pa art, pa shpirt*. Veçse, nëse dihet se kush ëndërronte ta shihte Kosovën ashtu, mbetet pa përgjigje pyetja se po tani, kush ëndërron ta shohi Shqipërinë kështu?



Ekspozita "Viti Zero" nga Gazmend Leka, në Galerinë FAB
9 - 29 tetor 2024

"Viti Zero" i Gazmend Lekës

Nga Ermir Hoxha



Në fillim u quajt: "Viti Zero". Të tjerë tituj erdhën më pas. U përmend aty viti i mallkuar, më pas viti i tmerrshëm, i Djallit, apo edhe Apokalipsi. Të gjithë mund të ishin. Të gjithë ishin të përshtatshëm. Por në fund natyrshëm zuri vend ai, "Viti Zero"; si për ta heshtur kërkimin dhe për ta kthyer atë përsëri në pikën Zero. Ashtu si nevoja e tij për një fillim të ri, a një fund përfundimtar.

Viti Zero i Gazmend Lekës, është një mozaik tragjesh të jetuara në dekadat e fundit. Si i tillë, ai është një imazh i njohur për shumë prej nesh. Një imazh ngjethës, në kufijtë e mosarsyes, ku logjika i la vendin marrisë, ndërsa kaosi mbretëronte bashkë me ndjellazinjte.

E gjithë kjo, ashtu si dhe më

parë, përbëhet nga dy qasje. E para, ajo më dominuesja përbëhet nga tablotë e mëdha në vaj; dhe e dyta, ajo me imazhet invers, realizuar në dimensione më të vogla në laps.

Tablotë në vaj janë 13. Për mjeshtrinë e kahershëm të gjuhës simbolike, ky numër nuk mund të zgjidhet rastësisht. Numri 13 mishëron energjinë e transformimit, rritjes pozitive, aq sa dhe rifillimit. Por për të rifilluar, duhet fillimisht të takosh nga afër fundin. Kështu Leka në 13 tablotë e tij shkoi të takojë sërish fundin.

Kështu, aty përzihen rrënimi i shtetit në vitin '91, në vitin '97, shpërthimet e Gërdecit dhe nëpër to gjithë siluetat e mbetura të kësaj vorbulle të përsëritur gjunjëzimi. Janë aty kronikat e dështimeve tona,


kur shteti rrënohej para syve të të gjithëve, çuditërisht në pak orë. Natyrshëm në to do përsëriteshin edhe gërmadhat e përzhitura, bashkë me perspektivat e zhdrejta të arsyes me në sfond shpërthimet megalitike të municioneve. Aty do mbivendoseshin dhe shtresëzimet e absurdit, mes monumenteve të Kultit të individit dhe mureve të shkaravitura të godinave.

E mbi këto sipërfaqe të mjera mbivendosen aktorët e radhës. Si në një tjetër *Theatrum Mundi*, ato shfaqen teksa mbledhin municione, thërrasin për mëshirë përballë turmave, apo shpejtojnë të rrëmbejnë bukët e fundit. Anash tyre zhurmojnë ithtarët e tjerë të marrëzisë, ndërkohë që shfryjnë dufin ndaj një grupi policësh,

a nxitojnë turravrap përpara një tanku që bën xhiro në bulevard.

Bashkë me ta gjenden dhe fëmijët. Denatyrizuar si ngaherë, ata janë dëshmitarët e pafajshëm të tragjedisë së të rriturve.

Në grupin e dytë Leka servir 30 vizatime. Një dashuri e hershme, ata përbëjnë vlerën e shtuar të ekspozitës. Është po ai imazh apokaliptik; porse zbërthyer krejtësisht ndryshe. Aty çka është dritë, bëhet errësirë. Çka është e qartë, bëhet e errët. Një *mimesis* i përmbysur, për të theksuar strukturën fantazmagorike të së gjithës. Aty kontrastojnë edhe viktimat, edhe heronjtë, të gjithë bashkë me municionet, kallashët, bukët e rrëmbyera, radhët e vajgurit, maskat dhe monumentet e namatisura.





E gjithë bota përmbys!

...

Por Leka nuk do të mjaftohej me kaq. Si shpesh ka ndodhur, ai kërkon dhe gjen një element plus. Një element të ndryshëm, brenda strukturës së të tërës. Një element, vulë a emblemë që shënon gjithçka. Ishte ashtu me kurorat e shenjtërisë që shndrisnin mbyturazi në mbikresën e endacakëve tek "...dhe yjet rrinë e vështrojnë" dhe numrat e viktimave të luftës së Kosovës tek "Abel". Këtë radhë ai shton

një element ekstra-piktorik, një numër fizik, me font industrial, treshifror. Është ai numri i Bishës, apo i Djallit. Është numri 666.

Ai shfaqet ngado. Në çdo tablo. Është aty si damkë që kjo nuk është vepër e njeriut, por e një force absolute sipërore. Është vepër e saj, përballë së cilës ne mbetemi të pafuqishëm, si aktorë të rastësishëm të tragjedi-komedisë së radhës.

...

Në historinë politike, termi "Viti Zero" zakonisht i referohet

institucionit të ndryshimit radikal. Si ide a gjendje emocionale, ai gjendet prezent në ato kultura, në kohën kur një shoqëri duhet të shkatërrohet plotësisht. Aty çdo gjë duhet të hidhet poshtë, sepse çdo gjë duhet të nisë nga e para. Ky qëndrim vetë-shkatërrues, rrjedh nga përpjekjet e individit për të mbijetuar psikologjikisht duke u ripërballur me konfliktet e veta.

Si i tillë, "Viti Zero" është një imazh vetë-shkatërrimi. Në këtë imazh, rrënimi total ka vend për gjithçka. Mund të shtohen tragjeditë e kronikave të fundit, sa dhe ato të shekujve të shkuar. Mes tyre do gjallonin personazhe të tjerë, të blatur si hije dhe bashkë me ta

mund të ishte edhe vetë ai. Sepse aty, ndërkallur mes gërmadhash, qëndron shpirtërisht dhe vetë ai. Mes tyre qëndron nevoja e tij për një fillim të ri, me të tjerë aktorë e të tjerë dialogë.

Prej disa vitesh, Leka e ka drejtuar vëmendjen tonë drejt atyre përthyerjeve tektonike, sa shpirtërore, aq edhe materiale. Si gjithnjë, në atë stacion sezonal të kalendarit vjetor. Ndërsa ka bërë këtë, piktura e tij është bërë gjithnjë e më e vyer, konsoliduar mirëfilli si vlerë sipërore. Aty do jetë dhe në vitet në vijim, për të vazhduar atë dialog personal që ka me publikun e tij, ashtu si pak-kush, nga nevoja për të rrëfyer, si gjithnjë, një rrugëtim ngjizur me imazhe.



LEXIM LETRAR, GJUHËSOR E STILISTIK I ROMANIT

“Një dashuri dhe shtatë faje”

TË REXHEP QOSJES

Nga Shefkije Islamaj



Romani “Një dashuri dhe shtatë faje” i Rexhep Qosjes dallon nga romanet që janë shkruar dhe që shkruhen në letërsinë e sotme shqipe. Ai paraqet një çintëgrimit të romanit klasik. Autori ka shfrytëzuar diskurse të ndryshme. Romani mund të quhet një lloj i romanit të ri historik, madje edhe roman psikologjik, por ai mund të quhet edhe roman poetiko-simbolik: paraqitet poetike i fshijnë kufijtë midis dy anëve të rrëfimit simbolik, në të cilin shkrihen historia, ideologjia totalitare, përsiatjet metafizike brenda shtresës poetike.

Romani “Një dashuri dhe shtatë faje” ka temë të veçantë, rrëfim të veçantë dhe gjuhë të veçantë. Duke pasur parasysh shtresën motivore e tematike, objektin në tërësi dhe shtresën semantike e simbolike, ai mund të quhet roman polifon. Të tillë e bën shumështrësia tematike dhe shumëkuptimësia në rrafsh të ndryshme. Me shumështrësia tematike kam parasysh *shtresën e dukshme*, shfaqëse, *shtresën me aluzione e simbole*, fshehëse dhe *shtresën thelbësore*, që ka të bëjë me procesin e krijimit, me njohuritë e idetë, lëvizjen e pikëvështrimit të autorit prej njërit personazh të personazhi tjetër, me pranëvënien e zërave të së tashmes e të zërave të së kaluarës. Romani trajton ngjarje të rëndësishme të një periudhe të rëndësishme në jetën e shqiptarëve të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi – ngjarjet e mirënjohura të vitit 1981, të shikuara në prizmin e fatit të intelektualit të quajtur Çerem Çapari. Në të vërtetë në roman nuk paraqitet vetëm drama e një intelektualit, e një njeriu, me bindje e parime të qëndrueshme jetësore, por edhe drama e shumë intelektualëve dhe njerëzve në një kohë tipike për shoqëritë komuniste.

Përpjekja që të kuptohet e të shpjegohet ana artistike e veprës letrare, siç dihet, nuk mund të kufizohet vetëm në hetimin e ideve dhe të mesazheve të saj, por duhet të drejtohet edhe kah ato elemente që përbëjnë mënyrën e rrëfimit dhe mënyrën e bartjes së ideve dhe mesazheve, pra duhet të drejtohet kah hetimi i stilit dhe gjuhës, Prandaj, rruga për ta kuptuar më mirë veprën letrare duhet të drejtohet edhe kah hetimi i gjuhës dhe i stilit. Shkrimtari ka zgjedhur procedurë interesante dhe me ngjyrë shumë individualizuese, vetjake dhe origjinale. Individualizuese e bën ritmin i veçantë gjuhësor, vetjake e bën sintaksa e veçantë, madje edhe fjalori i veçantë, origjinale e bën figuracionin i veçantë. Me ritmin, sintaksën, fjalorin dhe figuracionin, vepra krijon vlera të qëndrueshme gjuhësore-artistike.

Romani është ndërtuar mbi një lëndë shumë të pasur jetësore e intelektuale, lëndë që e ka burimin në përvojën personale të shkrimtarit, në erudicionin e tij kulturor dhe në faktet historike e sociale. Dhe kjo pasuri e larmi përmbajtësore, kjo përvojë e pasur intelektuale e njerëzore, kjo shumësi të dhënash kulturore, historike e shoqërore, ka kërkuar një gjuhë të pasur me shumëkuptimësi, një gjuhë shumë të pasur edhe nga ana formale e strukturore, ka kërkuar një gjuhë të veçantë.

Sistemi i pasur i figurshmërisë në nivelin leksikor, frazeologjik dhe sintaksor është i veçantë. Leksemat figurative, thëniet figurative, fjalitë me kuptim të theksuar figurativ, janë kategori të veçanta në shprehjen gjuhësore të autorit. Ato ka mundur t'i krijojë vetëm artisti me ndjenjën për ritëm, metaforë e simbolikë, artisti që

u nënshtrohet plotësisht fjalës e shprehjes së vërtetë poetike dhe gjurmuesi që arrin të depërtojë në fshehtësitë e fjalës e të shprehjes poetike dhe në shprehësitë që ofron tingulli. “Sa më i pakapshëm dhe më i paqartë simboli, aq më shumë fiton në kuptim dhe në fuqi”, na e thotë Umberto Eko¹.

Roman polihistorik

Romani “Një dashuri dhe shtatë faje” mund të quhet *roman polihistorik*. Çka e bën të tillë? E bën përmbledhja e përvojave të ndryshme artistike, krijimi i mozaikut prej gjedheve të shumëllojshme tregimtare dhe mbindërtimi dhe sintetizimi i të gjitha këtyre.

“Një dashuri dhe shtatë faje” është roman *polihistorik* edhe për arsyen pse trajton jetën e njeriut shqiptar në totalitetin e saj, në kohë të caktuar, në hapësirë të caktuar me refleksione për të gjitha kohët e për të gjitha hapësirat, roman për ngjarje të

¹ Umberto Eko, në intervistën dhënë Lila Azam Zanganeh-ut për revistën “the Paris review” me titullin: *Umberto Eko, The Art of fiction nr.197*, vjeshtë 2008, marrë nga <http://www.theparisreview.org/interviews/5856/the-art-of-fiction-no-197-umberto-eko>

caktuara, por ngjarje të para në tërësinë e tyre përmes shfaqjeve e rrjedhjeve të ndryshme, përmes përjetimeve e ndjenjave, në të vërtetë, përmes dramës individuale, por që reflekton dramën kolektive. Romani është një paraqitje tejet e plotë dhe interesante e realitetit social-politik e historik, një realitet shumë konkret e autentik.

“Një dashuri dhe shtatë faje” është roman *polihistorik* edhe sa i përket gjuhës, sepse romani i këtillë kërkon një gjuhë tërësore, të përpunuar e të aktualizuar në shkallë të lartë artistike. Mund të vështrohen në këtë kontekst për analiza gjuhësore e stilistike veçanërisht gjuha poetike e shkrimtarit, gjuha e Çerem Çapari dhe gjuha e Arben Begesë, gjuha e narratorit anonim në disa kapituj, gjuha e dialogut dhe sidomos gjuha e monologut, gjuha e përshkrimeve, ligjërimi intelektual, ligjërimi profesional dhe sidomos ligjërimi intim i Çeremit dhe Hana Ujëmiri, ligjërimi i përditshëm dhe ligjërimi familjar i personazheve, gjuha politike që del nga konteksti politik i temës së romanit, gjuha administrative e dokumenteve që jepën në fund të romanit, gjuha e dhunës dhe gjuha policore në bisedat informative, gjuha lirike, gjuha publike, gjuha e fshehtë e gjuha

simbolike - metaforike, fjalori dhe sidomos gjuha e asociacioneve, ligjërimi popullor i tregimit brenda romanit, e të tjera. Vëzhgimi i hollë i këtyre ligjërimeve do të nxirrte përfundime interesante për rrafshin e ndërthurjes së niveleve gjuhësore – do të provohet sa natyrshëm shkrihen muret a kufijtë gjuhësorë.


Mund të vështrohet gjuha edhe nga një anë tjetër. Çdo kapitull lejon mundësinë për vështrime me interes gjuhësor, sepse secili kapitull sjell veçanti gjuhësor, prandaj edhe mundësi për tipologji në rrafsh të ndryshme, analiza që do të ndihmonin përcaktimin e parimit krijues e artistik. Për shembull nëse kapitulli i parë *Profeti më kishte thënë* shpreh afri në shumë anë gjuhësore me kapitujt *Dita kur e kishte humbur kujtesën* dhe me kapitullin *Dita kur e kishte humbur zërin*, kapitujt *Hana Ujëmiri* dhe *Kolona e pestë e shejtanit* mund të vihen në një rrafsh, ndërsa *Fjalori i fshehur* qëndron më vete dhe jep mundësi për analiza tjetërfare në këtë rrafsh, ashtu siç dalin nga kjo rregullsi *Dosja kuqezi* dhe nëndarjet e titulluara *Nga fletorja e shënimeve*, që u prijnë kapitujve. Në këtë rrafsh dalin interesantë edhe nëntitujt, epigramet si kategori të veçanta gjuhësore, të përdorura me invencion këtu, dhe ndërftjet e teksteve të shkurtra ose të fjalive brenda kapitujve si ky: *Mexhid Toja e vazhdonte gjumin* e të tjera.

Për nëntregimet *Hirëmadhja* dhe *Tregimi simbolik*, tregime këto brenda tregimeve, janë shfrytëzuar tema interesante: në të parin rikujtohet një ngjarje e tmerrshme, fantastike, ndodhur në Vajazë, ndërsa në të dytin një subjekt nga letërsia popullore, në të cilin janë përdorur edhe mjetet gjuhësore e stilistike të këtij rrafshi, ashtu si janë përdorur me bollëk figurat stilistike në të parin. Kjo teknikë e futjes së tregimit në tregim pasuron përvojën tonë letrare e gjuhësore, ndërsa në roman këto nëntregime e pasurojnë strukturën e tij dhe ndihen shumë të natyrshme. Romani sjell edhe risi të tjera në këtë rrafsh.

Roman postmodern

Romani “Një dashuri dhe shtatë faje” mund të quhet për shumë arsye *roman postmodern*. Çka e bën të tillë? E bën bashkimi i tradicionales dhe modernes e bëjnë risimet në këta përbërës: në formën, në ndërthurjen e veprimeve narrative. Narracioni shumë individual si parim bazë, ligjërata e drejtë, përdorimi i citateve, i njësive të ndryshme bibliografike, i titujve të veprave të ndryshme letrare, filozofike e historike dhe i titujve të filmave, i emrave të shkrimtarëve, filozofëve, historianëve, artistëve, muziktarëve, piktorëve, tekstet hyrëse në krye të tregimeve, mënyra si fillon dhe si përfundon romani e të tjera; në strukturën e romanit hetohet një përqendrim i theksuar i vëmendjes në strukturën e tij, në natyrën dhe në shumësinë e asociacioneve, në praninë e ndjeshme të ironizimit, në metaliteraritetin, në praninë e stilit shkencor dhe, natyrisht, të fantastikes.

Po kështu, shumësia e temave, e motiveve, e personazheve dhe e karaktereve në romanin “Një dashuri dhe shtatë faje” ofron prova se autori mbështetet në përvojën e romanit postmodern, ashtu siç dalin këto prova edhe në organizimin e veçantë dhe jotipik të tij, në strukturimin e njëkohshëm të zërave



Ernest Baba - Fituesi i konkursit ndërkombëtar të fotografisë “Fokus Award 2024”

Nga Qerim Vrioni

Para disa kohësh u zhvillua në vendin tonë konkursi vjetor ndërkombëtar i fotografisë “Fokus Award 2024”. Kësaj rradhe, veprimtaria, e cila e ka zanafillën e saj para 15 vitesh në Fier, filloi në Tiranë dhe përfundoi po në Fier, së pari në Galerinë “Vilson Kilica”, mandej në Teatrin “Bylis”, ku u shpallën fituesit. Fillimisht ky konkurs kishte karakter më tepër lokal. Më vonë, vit pas vitesh e hap pas hapi, shtoi kërkesat estetike ndaj pjesëmarrësve dhe zgjeroi hapësirën gjeografike të tyre, duke e kthyer këtë në konkurs ndërkombëtar. Po ashtu, kjo veprimtari mbetet, tani për tani, gara e vetme për krijimet e fotografëve në vendin tonë. Përmendim me këtë rast konkursin fotografik “Çmimi Gjon Mili”, që zhvillohet me sukses çdo vit në Prishtinë, në fillim të vjeshtës dhe organizohet nga Galeria e Arteve të Kosovës ashtu siç organizohej disa vite më herët konkursi “Marubi” nga Galeria Kombëtare e Arteve të Tiranës.

Mund të thuhet se konkursi “Fokus” tashmë ka arritur një nivel të kënaqshëm artistik. Meritat për zhvillimin e “Fokus Award 2024” iu takojnë së pari organizatorëve; drejtorit artistic dhe ideuesit Arben Alliaj, menaxherit Saimir Ahmeti dhe kuratorit Elton Koritari. Konkursi kishte temë kryesore “Prek me sy” (“Touch with eyes”). Me këtë rast shtojmë se Ernesti i kushtoi, shumë i prekur edhe fjalët e para gjatë ceremonisë së marrjes së “Çmimit të Madh” në natën finale, djalit të tij të vetëm, Kristit, i cili fatkeqësisht u

Tema “Prek me sy”, duke nënkuptuar,



prek me shikim, që krijonte para fotografëve hapësira të gjera për kapje imazhesh mbresëlënëse, gjetje e mirë goditur e organizatorëve të tij. Me “Çmimin e Madh” të konkursit u nderua një foto e ish-fotografit të njohur të ATSH-së (Agjensia Telegrafike Shqiptare), Ernest Baba. Të gjithë anëtarët e jurisë, midis tyre edhe nga shtete të tjera, e votuan njëzëri përzgjedhjen e fotos fituese të Çmimit të Madh të “Fokus Award, 2024”. Madje edhe titulli i saj ishte “Prek me sy” (“Touch with eyes”). Me këtë rast shtojmë se Ernesti i kushtoi, shumë i prekur edhe fjalët e para gjatë ceremonisë së marrjes së “Çmimit të Madh” në natën finale, djalit të tij të vetëm, Kristit, i cili fatkeqësisht u

nda nga jeta para 3 vitesh (14 tetor 2021) në moshën 30 vjeçare. Kristi, ishte një piktor i ri shumë i talentuar, i cili kishte kryer me sukses studimet për pikturë në Institutin e Lartë të Arteve, madje kishte hapur edhe një ekspozitë vetjake mjaft të arrirë. Fati i keq ia preu ëndrrat e mëdha e të bukura këtij artisti të ri, prindëve të tij dhe miqve të shumtë.

Ernest Baba, i lindur në Tiranë, por me origjinë nga Shkodra, e kishte të atin, Rrok Baba, mjeshtr të talentuar të punimit të filigranit, ndërsa vëllai i tij më i madh, Nikolin Baba, është fotograf i njohur. Ky i fundit, është i dalluar sidomos për albumin “Arti Popullor Shqiptar” (shtypur në Kinë) dhe korpusin fotografik me veshjet popullore shqiptare, të botuar në pesë vëllime. Pra, mjedisi ku u rrit ai nuk ishte shumë larg trajtimit të imazheve dy dhe tri përmasore në fushën e arteve pamore.

Pas mbarimi të Liceut Artistik për pikturë, Ernesti u punësua si specialist në laboratorin optik të Ministrisë së Mbrojtjes dhe së fundi, më 1987, në ATSH, pranë fotoreporterëve të njohur të kohës si Petrit Kumi, Gani Xhengo, Petrit Omeri etj. Përmendim se, në një farë mase, atëherë ATSH-ja, shërbeu edhe si një “shkollë” pa program mësimor për fotografët e rinj në përvetësimin e mjeshtrisë dhe teknologjisë së fotografimit. Aty, Ernesti u shqua për përkushtim dhe aftësi profesionale, madje ai bashkëpunoi ngushtë edhe me fizikantin e njohur të Universitetit të Tiranës, prof. Kostandin Leka. Ky ishte shquar për zotërimin dhe përhapjen në vendin tonë të proceseve të reja teknologjike të “dhomës së errët”. Madje profesori i nderuar shkruan rreth dy faqe në një libër të tij vetëm për Ernestin. Shkëpusim këtë opinion nga libri për punën e Ernestit: “Unë kam pasur rastin të punoj gjatë me Ernestin dhe “të ndjej” mirë, jo vetëm aftësitë, por edhe dashurinë e madhe që ai ndjente për fotografinë” (K.Leka -“Një jetë në shtjelljet e krijimtarisë”, Tiranë, 2013,

f.271). Ndërkohë, Ernesti merr pjesë në disa seminare për fotografinë edhe jashtë vendit si në Itali (Romë dhe Milano) duke zbatuar mandej me sukses në punët e përditëshme mësimet teorike dhe praktike të tyre.

Nuk duhet lënë pa përmendur pjesëmarrja e Ernestit me foto në disa ekspozita të organizuara nga ATSH-ja para dhe pas viteve ‘90, në veçanti ajo e hapur në bashkëpunim me agjensinë e njohur franceze të lajmeve AFP, në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë në vitin 2011. Gjithashtu, ai është paraqitur me foto të goditura në disa edicione të konkursit “Fokus” në Fier, tek “Ditët e fotografisë në Pogradec 2017”, gjatë veprimtarisë “Gjon Mili-Photography Days”, Korçë, 2018-2019 dhe në festivalin e fotografisë “Punctum” në Gostivar të Maqedonisë së Veriut, 2022-2023. Ia vlen të shtojmë edhe punën e tij të kujdesshme në printimin në formate 50x60 cm, të fotove me ngjarje të viteve 1998-99 në Kosovë të fotoreporterit prishtinas Ilaz Bylykbashi. Ekspozita me këto foto u hap në vitin 2002, në Kosovë dhe në Gjermani.


Në prill të vitit 2018, me rastin e daljes në pension të fotografit Ernest Baba, ATSH-ja, organizoi në mjediset e COD-it, pranë Kryeministrisë ekspozitën retrospektive të tij me titull “Fokus”. Aty përfshiheshin fotot më të zgjedhura nga krijimtaria e gjatë si fotograf e Ernest Babës. Kjo ekspozitë u ndoq me mjaft kureshtje nga publiku dashamirës i fotografisë dhe media. Ajo u shoqërua edhe me një ceremoni-koktej të veçantë për nder të punës së tij pranë institucionit. Dalja në pension nuk ia shkëputi lidhjet me fotografinë, siç u cek edhe më sipër, madje ai vazhdon të fotografojë thuajse çdo ditë subjektet që e tërheqin e që pasqyrojnë njeriun në përditshmërinë e tij, por edhe peizazhe urbane të studiuara.

Nga fundi i periudhës së punës pranë ATSH-së, Ernesti u mor me përkujdesje të madhe edhe me arkivin, fondin fotografik të institucionit, i cili përfshin dokumentimin me foto të një pjese të rëndësishme të historisë së Shqipërisë në gjysmën e dytë të shekullit XX. Arkivi fotografik i ATSH-së, përbën sot, por sidomos në të ardhmen e vendit, një “minierë ari” për historianët, urbanistët, publicistët, arkitektët, shkrimtarët e të gjithë studiuesit.

Fotoja fituese “Prek me sy” e Ernest Babës, paraqet një skenë nga jeta e rrugës, një invalid me paterica i cili ka ndaluar pak çaste dhe po vëren manikinat brenda vetrinës së një dyqani, dy këmbë plastike të një modeleje.. Ajo është shkrepur, siç është shprehur në një intervistë në TV vetë Ernesti, nga dritarja e shtëpisë së tij në kohën e pandemisë së Covid 19, kur kishte kufizim qarkullimi. Ernesti, si një “gjahtar race” shpesh mbante aparatit në duar dhe vështronte nga dritarja për të kapur skena të veçanta nga rutina e kalimtarëve, gjithmonë në padijeni të tyre. Ai ka realizuar nga dritarja e tij shumë foto ato kohë sa me to, mund të hapi një ekspozitë të gjinisë “fotografia e rrugës” (street photography).

Fotoja jonë është bardhë e zi dhe shkrepur në një ditë pa diell. Fotoja e godit shikuesin me dramën e përhershme të invalidit, një skenë shprehëse të së cilës ka kapur në këtë shkrepje fotografi ynë. Subjekti i fotos hap disa shtigje të shumta interpretimi ndjesore dhe të menduari, gjithmonë njerëzore. Pra, mendojmë se edhe vendimi i jurisë ndërkombëtare ishte plotësisht i goditur.

Dikush mund të jetë habitur me emrin e fituesit të “FokusAward 2024”, sepse Ernest Baba, përveç se njeri me natyrë shumë paqësore mbetet edhe si ikonë e modestisë, sepse ai nuk ka “profil të lartë publik”. Ai ka profil të lartë, siç u shtjellua edhe më sipër, në nivelin e krijimtarisë dhe punës së tij në lëmin e fotografisë me të cilën ai ka lidhur pazgjidhshmërisht jetën e tij, çka e tregoi edhe nderimi me “Çmimin e Madh” të “Fokus Award 2024”.



Qerim Vrioni, 2013



Trazime në tërsëllimë.

Më kishte marrë malli për këtë det të trazuar.
Det i dhuruar përjetësi.
Atë që mbajmë brenda vetes mall.
Atë që s'mund të ikë sërish.

Mall për këtë det në trazim.
Si të vërtetat me tërsëllimë.
Ato që prehen brenda vetes heshtur.
Ato që s'duhet t'i lëmë ikje sërish.

Më kishte marrë malli për këtë det trazimesh.
Si mbërrtija të fjeturve pas përjetësisë.
Ata që s'mund të vdesin dy herë.
Ata që mbeten det i tillë sërish.

Në folenë e erës.

Reja ngjan me një levozhgë të një peme
Shekullore.
Sqepi i një shpendi çukit fjetet e erës të
Ndërtojë fole pa tundimet e Penelopës
pranë.
Në supin e një njeriu mbërriti supi
vjeshtës,
gjethja e parë.
Kjo pëllëmbë që kur mbërrin puhizë në
Trupin tim baltë dëgjon cicërima
Puthjesh dikur.

Ngrihet.

Ngrihet dallga në krenarinë e njeriut të
ndershëm.
Me muskuj të bardhë flatrash të së drejtës
shkulmon
Energji të prekshme ideali.
Grushtët sikur do thyejë brigje shkëmbore
në mbërritje.
E mrekulluar si njeriu më i lumtur.
Kur mendon se qielli mbetet ringjallje.

Nga pas i vjen velë horizonti era.
Është materia që lë pa gjumë të gjitha
vdekjet.
I dhuron plagët më të thella në breg
dallgëve.
Heroizmi s'mund të jetë prë e vdekjeve.

Krenohet dallga në fjalë magjike.
Fjalë e thënë thellësisht fshehtësisht deti.
Ajo që ne e shqiptojmë më shumë heshtur.
Por që na lumturon pavdekshëm.

Aromë.

Dielli hesht përmes ndriçimit.
Nxehtësia është verbim i tulit të
Lumturisë.
Dita është e qeshura me gjithë shpirt.
Dhe loti një gonxhe luleje që e pshon
Të gjitha dashuritë.
Nga gishtërinjtë e degëve bulëzojnë
Mollëza frutesh.
Puhizat e erës afshohen lutje burri
Në dëshira për të mos dhënë vetëm një
Kafshim...

Lutje aromash.

Ajri është ëndërr në pranverë.
Goja ndjehet më shumë frut i kafshuar.
Aromat e luleve janë të gjitha ngjyrat e
dashurive.
Puhizë e erës pezullni e puthjes grua.

Sheh mëngjesin dhe ndjen fëminë brenda
vetes.
Në trup kur ecën të rëndon pesha e një
peme.

ILIR PAJA

Një lutje vjeshte

poezi



I përkëdhelur nga të gjitha çeljet e
gjetheve.
Rrezja e diellit që djersin freskinë e hijes
tënde.
Pasditja është rrëshirë gjaku në pritje.
Dhe muzgu me yjet e gjinjve që fsheh grua
të zhveshur.

Një zog qesh me cicërimat.
Krahët e tij nuk janë përqaftime nga
ëngjëjt.
Zukatja insekteve tërheq pas vetes të
gjitha enigmat.
Dhe atë më të fjeturën, të pandodhurën, të
padukshmen,
heshtjen.

Në ëndërr hyj pemë e çelur.
Me hijen nga pas që s'më arrin dot.
Vrapoj aromë trupi të lë puthjen në hoje
bletësh.
Brenda djersisë së natës me flokët e mia
Të ndërtoj një fole për zogitë.

Shije.

Qielli është mundim i madh
Në etje.
Kur vë shputat nëpër yje.
Ndjehesh i kryqëzuar me vesë
Nate.
Heshtja ka shijen e pluhurt
Të hënës.
Kërkon ujë dhe pin lotin
Tënd që zbret si vetmia.
Nga sy i vdekur.

Mërzia.

Është feta e bukës
E lënë prej ditësh në tryezë.
E zbut me gjalpin e puthjes
Dhe të rikthehet shija e qumështit.
Një gotë me lëng frutash
Është gruaja pas dushit.
Thika, burrëria ku mërzia
Ndjen trembje fëmije para teje.
Feta e bukës tretet në thërmija.
Ngrihesh pa ngrënë
Dhe sheh mërzinë të shkundë
në duart e tua mbulesën
e sofrës pa thërmija.

Vjeshta, kjo pranverë e së shkuarës.

Qerpikët e pishave,
këto tendina që burrërojnë
me muskuj erën.
Kundërmimi rrëshirës e ngre
Hijen e pemës në frut.
Nga trupi erës verdhimi ndriçon
Netët e rrënjëve.
Fluturimi gjetheve është buzëqeshje.
Vjeshta, pranverë e së shkuarës,
që dhuron shtegtimin dhe jo vdekjen
e gjetheve.
Të gjitha ringjalljet hedhin supeve
Trupin tonë të heshtur.

Të ngrihesh mëngjes.

Dielli është akoma ëndërr qielli.
Malet ngajjnë si varri i madh i të
Gjitha vdekjeve.
Toka fle ende natë pasi nis të fshehë
Nën plisa yjet.
Pemët janë të ngjallurit e vetëm nga ikjet
E njerëzve.
Dielli shfaqet prush i madh në agshlim.
Tani nata është hiri zjarrit
Dhe dita që përgjon vdekjet në kthim.

Kopsë e hënës.

E plotë, e zjarrtë, e kuqe në lumturi.
Nata ndjen se është brenda vetes verë
qielli.
E shtypur në një anë.
Është trupi gruas që dhuron ëndërrën.
Por zhveshjen e ruan ikje...
E vogël në dunë erërash me një qiell
Plot beteja.
Sumbull kapote ushtari.
Qielli në vrasje është vdekja.
E ngrënë, hëna është uri e natës.
E mprehtë në tejdukshmëri.
Gjakos të gjitha heshtjet.
Është manshetë këmishë në darka
Koktelesh.
Ku lumturia mbrëmjes
Zbret yjet fruta në pije.
Pa hënën qielli është nudoja shpirtit
Që s'mbërrin te trupi.
E bardhë si pragu i një shtëpie.
Lyer nga një amvisë.
Nata ndjehet mëngjes dhe djersin
Këtë çorape hëna me
Këmbën tjetër zbathur.

E njëjta përjetësi.

Do të doja ta humbisja thinjën
E moshës.
Aty ku dielli mbetet përjetësi
Dhe perëndimi fshehtësi.
Rudhën e ballit do ta doja
Ta shihja gjithnjë horizont.
Gjurmën e saj vetëm dallgë
Të kreshpëruar në breg.
Përjetësia mbërrin sonte
Hëna e plotë.
Ndërsa unë të gjurmoj plagët e saj
Të rëna në tokë.
Dhe ti fashoj si fëmi.

Gruaja e vjeshtës.

Ajo është pemë.
Rrënjët e saj mbështillen nga
Dhëu i gjoksit prej burri.
Gjaku tundohet të joshë për
Frut hënën e muzgut.
Puthja ime është era.
E mbështjell dhe shpejton
Mes gishtërinjve të degëve
Harbuar.
Ajo është pasdite e artë.
Gjethet e saj veshin këmbën time
Të zbathur.
Unë ndjek aromën e rrëshirës
Që të dehem i ngritur hije peme.

Të gjitha frutat.

Të gjitha frutat shkrihen dashuri
Brenda trupit.
Vetë hija tyre nuk zbriste aq fshehur
Nga buzët.
Kur mbrëmja ngriti fshehtësinë e saj
Pa e treguar pemën.
Hëna nuk ishte këputur ende e papjekur.
Dhe nuk ishte e bukur formë gruaje.
E shtypur në një anë.
Pjesa e fshehur ishte pagjumësia e
Rënieve të gjetheve.
Të gjitha frutat shkrihen brenda
Gjetheve marrëzi ere.

Ngjyra.

Vjeshta ka ylber të saj verdhimin
E artë.
Dhe një frut dielli.
Shija e tij është kundërmimi njeriut
Që mbërrin brenda vetes mbrëmje.
Ndërsa hija e tij një rrugë hëna.
Që nuk shkel mbi ylberin e gjetheve.

Mbërritje.

Në molin e muzgut mbërrin kokë e diellit.
Nuk ka pamjen e asnjë filozofi, të asnjë
lideri.
Është thjeshtë materie ku mendimet janë
kacavierur
Pas mishit dhe gjakut.
Zbresin nga nata të gjithë të rënë.
E dinë që qirinjtë dhe pse ndezur,
por më shumë janë sklepa të gjumit.
Më pas mbërrin etërit.
I dhurojnë thinjat qiellit
Dhe nata mendon se është dëborë
E çmendur.
Më pas arrijmë ne.
Të trembur si pagjumësia.
Në detin e natës nuk pluskon
Asnjë ëndërr si vala në breg.
Toka në terr është vdekje
Me gurin e hënës te këmbët.
Që prekin muzgun vetëm
Brenda këpucëve tona.
Çorapja e hequr, kjo mjegull pylli
Që qëllon yjet me shigjeta hijesh...

drita brenda nesh

kjo ditë
e plogësht, si një disk
gri, e palexueshme
refren i përditshëm gjërash të
përsëritshme,
e aq më shumë, të mërzitshme.

vetëm ti e ke në dorë atë rreze të beftë
ndryshon diçka në atë disk gri,
e bën të ndriçojë!

at'botë e kuptueshme është
fakti, që përveç të tjerave,
gjendet një dritë brenda nesh
të cilën shpesh, pa dashje
ia dhurojmë krejt rastësisht,
njeriut, që gjithë jetën,
nëpër ëndrra zë e na shfaqet!

këngë e hershme

Të preka me dorën që dridhej
ishe plagë e ngrohtë heroit të rënë
zemra si një zog hidhej,
mbi fjalë binte dritë e argjendë!

përgjova nën këtë dritë magjike
lulen dhe pyllin
një mal, një lumë një zog
diellin dhe hënën
agimin, kur ia zinte natës yjet rob.

të takova tek një baladë e vjetër
e në sytë e trembur të një vajze!

mendova, sekretin tim s'duhet ta dinte
njeri,
të fshehur dashurinë time e lashë
në një fletore të shtrenjtë
brenda valixhes së drunjtë, në shtëpi.

kaluan shumë kohë
nuk ndahesha nga ti, poezi
ditët ishin ura afrimi me ty!

kam qarë ndonjë mbrëmje,
kur vetminë tek sytë e tuaj,
më ngjau se e pashë!
kur jam zgjuar në mëngjes,
kemi qenë prapë bashkë

kënga

kur ulem ta shkruaj këngën
besoj se asht e imja,
kur e mbaroj këngën
e shoh se jam i asaj!

krijesë

gjatë ditës gjer në mbrëmje
një djall që më pushton nga brenda
copë copë më bën,
si i vdekur gjendem.

pastaj, kur zgjohem të nesërmen
i ngjaj Zotit,
me copat e tepruara
e rikrijoj veten.

Mitrovicë

në rritjen e tyre të natyrshme
pemët i zgjerojnë degët
nga veriu,
prijen drejt veriut gjithë gjelbërim.
nëse unë ngjaj me një pemë
Mitrovicë...je veriu im!

stuhia

stuhia filloi.
qiejve, retë e egërsuara,
mes vetetimave dhe gjëmimeve,
pyllit iu hakërryen
në pyll ndodhi gjithçka!
pishat u përkulën gjer në tokë
dhe jetuan,
por lisat,
ah lisat!
... u thyen!

PRENG MACA

Drita brenda nesh

poezi

**nesër(?)**

nesër do të vij,
nesër më prit,
kjo gjë do të ndodhë nesër!
do të jetë më e bukur jeta nesër!
nesër do të jemi të lumtur!...
çdo ditë jetojmë të sotmen e vështirë
e ti qesh e më thua: "nesër, nesër, nesër..."
e kam menduar këtë fjalë qëkur ;
"a thua nesër do të thotë kurrë?"

çifteli

unë jam një çifteli
tingëlloj,
kur ti më merr në dorë

bëhem e gjallë,
dridhem
e nxjerr një zë
e mue bash at' botë
më shohin të gjithë

po ç'faj kam unë
që në të jetuarin tim
duhet patjetër të dridhem
bashkë me kangën!?

o këngëtar...
jam në dorën tande!

delja nënë

(baladë)

Na kishte bariu një dele të urtë
syri, si njeri i vështronte
bënte çdo vit nga një qingj të butë
por asnjë nuk jetonte

shtatë qingja të bardhë, si bora i lindi
asnjë nuk u rrit në vathë
çdo vit ja kalbte nën dhe, pylli
mes lisash të lartë

blegërinte delja nga dhimbja, blegërinte
"si nuk jetoj as dhe një qingj!?"

bariu gjuhën e saj nuk e dinte
dhimbjen jo se jo, natyrisht

tha se ajo, s'që nënë e mirë
të vegjlit nuk i donte aspak...
thikën në fyt i vuri një ditë
po nuk rrodhi, pik gjak

kur ja hapi zemrën... në zemër delja kishte
shtatë plagë të vogla, shtatë vrime
dhimbja prej nënë në plagë kthyer ishte,
si nëpër shtatë fyej, blegërinin shtatë
qingja!

treg

shitësit e butikëve,
përpiqen të shesin veshmbathje,
furrat e bukës shesin bukën e përditshme,
botat me ujë Selite, shesin ujë
fshatarët dalin të shesin perimet e stinës,
blegtorët shesin qumështin,
kasapët mishin e bagëtive,
grykatësit...shesin drejtesinë,
politikanët blejnë dhe shesin ...
Atdheun tim, Shqipërinë.

fati

fati im sa më tremb!...
kur të kërkoj, ti më harron
kur të harroj, ti më ...gjen!

flutura

Një natë të qetë, mbushur me pranverë
nga dritarja e dhomës hyri një flutur
u ngrita, e zbova me gjeste nëpër erë:
"më lër të qetë moj mysafire e bukur!"

dhe iku...dritarja përsëri e hapur
kaluan pak çaste dhe e desha atë
e thirra...e prita më kot zemërakull...
ç'e zbova aq lehtë nuk vinte tanimë!

mendim

nëpër ëndrra.
kopshtin e hireve të tua
bredh vend për vend!
kur më del gjumi
mbes pa...mend!

molla

në dorë kam një mollë të kuqe e të artë
në pëllëmbë të dorës më shndrit ajo
thua gjithë dielli i ditës është futur brenda
saj,
por unë se ç'kam...s'jam i gëzuar, jo!

jo se kjo mollë nuk është vërtet e hijshme
është krejt e tillë e s'ka njeri ta shajë,
nëse fytyra ime është disi e trishtme
kjo ndodh, se mollën...nuk kam me kë ta
ndaj!

lutje në shi...

bie një shi i furishëm sonte
rrodhi trotuareve thujt dhe mbuloj tokën
e lagu qytetin e madh ky shi,
i paparë
por,
në çast sa pushoi,
rrugët gjithë baltë sërish dhe bota
prap e palare.

O Krishti im
deshe të na lësh mendjen në vend,
kur na the se do të ringjallesh?
të lutem ngjallu e ulu nga kryqi,
ku të gozhduam,
se duke të pritur ...u kalbëm!

flatrat

(Poetit Agim Spahiu)

Miku im të lutem ruaju!...

më trishtove kur më the,
se të kanë dalë flatrat
dhe me fluturime i sheh ëndrrat

është e vështirë të kesh flatra.
(këto gjëra të veçanta më trembin)
kur t'i kesh ato flatra, duhet t'i fshehësh
ndërsa përpiqesh t'i fshehësh ato
dhembin.
pastaj ti do të jesh në një dhembje të
vazhdueshme dhe të padurueshme
do të kërkojsh ndoshta më pas që t'i
presësh

por e pamundur o mik i vlerë! A e di?
nëse do t'i presësh
ti do të vdesësh...

sa fatkeq je o njeri...
mes tokësorëve
një flatrambajtës si ti!

e sotme

e sotmja është tejet e vështirë,
gënjeshitare, gërrnjare, e pabesë,
e fortë dhe e papushtueshme,
e frikshme dhe pa të ardhme
asnjeri këtu nuk mendon të hapë,
rrugën e një të nesërme!

lodhem, shtrihem të fle, të pushoj,
ose më mirë të harroj,
e sotmja është aty jashtë
një prostitutë e vërtetë,...
sapo u kthye nga vizita tek gjinokologu
dhe mban në dorë që nuk i dridhet
një dëshmi virgjërie.

shfletim libri

ah është e saktë dhe e qartë
drejtësia, e vërteta
dhe lumturia
hyjnë në gjërat fort të rralla.

nëse do t'i hasësh vërtet ato,
hap librin e përrallave!

"Palajt çka i takon Palajt."
Aurel Plasari'

1.

Bernardin Palaj lindi në malësinë e Shllakut të Shkodrës më 20 tetor 1894 dhe kaloi në amshim në konviktin - burg "Malet tona" të qytetit të Shkodrës më 2 dhjetor 1946.

I biri i Gjonit dhe i Martë Dedaj u pagëzua me emrin Zef. Ai ndoqi seminarin françeskan në Shkodër. U vesh frat me 15 shtator 1911 dhe mori emrin Bernardin. Kushtet e para Bernardini i bëri më 1 nëntor 1912, ndërsa kushtet e përjetshme më 14 korrik 1917.

Ai vijoi studimet e larta për filozofi e teologji në Salzburg e në Innsbruck të Austrisë, ku ndoqi edhe kurset e rregullta universitare në fakultetin e letërsisë. Më 2 gusht 1918 Atë Bernardin Palaj O.F.M. u shugurua meshtar.

Nga 15 prilli i vitit 1923 e gjer më 24 dhjetor 1924, Bernardin Palaj së bashku me Lazër Mjedën, Ndre Mjedën, Gjergj Fishtën, Anton Harapin, Zef Mark Harapin, Vinçenc Prennushin, Lazër Shantojën, Kolë Kamsin, të prirë nga Luigj Gurakuqi botuan në Shkodër, gazetën opozitare të përjavshme, politike, shoqërore, ekonomike, kulturore e satirike "Ora e Maleve". Aty nisi një bashkëpunim i frytshëm i poetëve Hilë Mosi, Ernest Koliqi dhe Bernardin Palaj.

Për disa vite Atë Bernardin Palaj qe mësues në gjimnazin "Illyricum" të qytetit të Shkodrës. Gjithashtu ai shërbeu edhe si famullitar në zonat rurale Toplanë, Palç, Shalë, Bushkash, Rubik.

Periudhën e parë të veprimtarisë letrare (1919 - 1934) Bernardin Palaj ia kushtoi gjurmimit të rapsodive të Malësisë së Veriut. Më 1937, bashkë me Atë Donat Kurtin, botuan në Tiranë vëllimin e dytë "Visaret e Kombit. Kangë kreshnikësh dhe Legjenda". Ky libër me material folklorik të pambledhur e të pastudiuar më parë është i shoqëruar me një "Parathanje" dhe me një "Hymje", shkruar metodikisht përmes çelësave të artë interpretues.

Periudhën e dytë të veprimtarisë letrare (1933 - 1941) Bernardin Palaj ia kushtoi hartimit të poemave me një stil të ri mjaft original, të cilat i paraqiti tek revista "Hylli i Dritës", Shkodër. Ai përdori pseudonimet "Kukel Lapaj" dhe "Costandinus". Të gjitha krijimet e tij në vargje, prirë me një "Introduzione" të shkruara prej saj, studiuesja italiane Angela Cirrincione ia botoi në Romë më 1969, në librin shqip - italisht me 214 faqe, të titulluar "Bernardin Palaj. Opere. Volume I. Poesie".

Periudhën e tretë të veprimtarisë letrare (1941 - 1944) Bernardin Palaj ua kushtoi studimeve mbi juridiksionin e malësisë, mbi organizimin fisnor, mbi etnografinë, mbi mitologjinë etj. Këtë korpus e botoi në Shkodër te "Hylli i Dritës" (1941 - 1944) dhe në Tiranë tek antologjia "Bota Shqiptare" (1943). Firma e tij u shpalos gjithashtu edhe në kryeqytetet Tiranë - Romë, tek përmbledhja "Studime dhe Tekste Juridike. Nr. 1" (1944).

Mbas ndjekjes minucioze shteruese të krijimtarinë mozaik, si dhe shkoklimit të kontributit plot spikatje të shkrimtarit poliform Bernardin Palaj për antropologjinë kulturore shqiptare, arrijmë në përfundimin "Palaj mori në popull diçka. Pastaj i ktheu atij gjithçka." (2)

Bernardin Palaj ishte pjesëmarrës më 1940 në Kongresin e Studimeve Shqiptare, Tiranë, ku u zgjodh anëtar i Institutit të Studimeve Shqiptare, bashkë me Lasgush Poradecin, Aleksandër Xhuvanin, Eqrem Çabejn, Kolë Ashtën, Ethem Haxhiademin, Karl Gurakuqin etj..., nën drejtimin e Ernest Koliqit. Ai dha ndihmesën e tij tek vëllimet "Studime dhe tekste", që shpalosën vlerat shkencore të këtij institucioni.

Mjafton veç një paraqitje shembullore stili në prozën eseistike të këtij autori ekselent, shumëplanesh, ku vetëm fraza oratorike

TRE REFLEKSIONE NË 130 - VJETORIN E LINDJES SË POETIT DHE KULTUROLOGUT ATË BERNARDIN PALAJ

Prof. dr. Alfred Çapaliku

- filozofike - poetike - kilometrike arrin të shprehë ndjeshmërinë e tij ndaj rrënjëve etnike dhe të pasqyrojë ndërgjegjësimitin e ngulitur të Atë Bernardin Palajt ndaj vlerave origjinale të kombit shqiptar:

"Kush i a mësoi malcorit të maleve, rritë me një natyrë aq të vrashtë, ndoshta neper do lera a në ndoj humnerë të shembbleshme, ato fjalë aq të bukura, tanë njomsia njerzije, fraza qi bindin letrarin ma të mirin, kur t'i binë tërhjekse e së parit në vesh, e lakmi po me ia pasë vjershtari ma i nalti per ato shprehje tanë zemër e bujarie e njomsia mendimesh, të cillat aj i zgjedhë e i rreshton retorikisht per me i ardhë rreth mikut e me i a ba disi ma të kandshme atë kohë, në të cillën mikut i takon me e kalue buzë votrës së tij?" (3)

2.

Sipas gazetës "Koha e re" të Shkodrës, me datën 19. 11. 1946, një arkë me dokumente me rëndësi të Padër Bernardin Palajt do të gjehej gjatë zbulimeve sensoriale në Kuvendin Françeskan...

Ndërkohë shkrimtari i gjenealogjisë së kombit, i arrestuar me akuzën false për futje armësh në kishë, torturohej në kuvendin françeskan të Gjuhadolit.

Vdiq nga tetanozi, shkaktuar nga teli i ndryshkur me të cilin ia kishin lidhur duart, më 02. 12. 1946. Atë Bernardin Palaj u varros në një vend të panjohur.

Për një gjysmë shekulli vepra enciklopedike e Atë Bernardin Palajt O. F. M. u përjashtua nga sistemi i vlerave të letërsisë dhe të kulturës shqiptare brenda kufijve shtetërorë.

Në kundërshtim me këtë qëndrim mohues, vlerësimet e merituar par excellence

dhënë nga sivëllai i tij Atë Gjergj Fishta, nga shkrimtari kohanik me të Ernest Koliqi, nga studiuesja italiane e veprës së tij poetike Angela Cirrincione, si dhe nga poeti e kritiku i emigruar në SHBA Arshi Pipa, njohës i krejt opusit paljan; e ngenë Bernardin Palajn atje ku e ka vendin, në panteonin e letrave shqipe.

GJERGJ FISHTA:

"Ky (Bernardin) ndodhej aty pranë) ka talent të madh dhe e njëjshqipen me themel. Mund të ma kalojë edhe mue." (4)

ERNEST KOLIQI:

"Ai (Palaj) në vjett Tridhjetë) qe një prej atyne që u dhanë shkas, kah një zhdrivillim ma të përkueshëm me frymën e kohës, letrave tona." (5)

ANGELA CIRRINCIONE:

"Në frymëzimin e fuqishëm të Atë Bernardin Palajt nuk i vihet fre formës dhe shijes klasike." (6)

ARSHI PIPA:

"Palaj shfaqet si një njeri me pregtitje tejmasë të gjanë e të thellë në letërsinë klasike e moderne, i cili, nëpërmjet dhantive të tija të jashtëzakonshme si autor, e pati ngritur të shkruemit në sferat ma të nalta të artit," (7)

3.

Pavarësisht se para viteve nëntëdhjetë të shekullit të njëzetë dhe sidomos pas viteve '90 e deri më sot janë botuar studime të mirëfillta për Atë Bernardin Palajn, nga Fulvio Cordignano, Angela Cirrincione, Giuseppe Gradilone, Ernest Koliqi, Karl Gurakuqi, Arshi Pipa, Agnia Desnickaja,

Robert Elsie, Aurel Plasari, Isak Ahmeti, Anton Nikë Berisha, Zef Simoni, Tonin Zadeja, Zef Pllumi, Pjetër Pepa, Donat Kurti, Gjergj Zheji, Simon Pepa, Ledri Kurti, Hasan Hasani, Daniel Gjeçaj, Ndoc Papeleka, Leonardo di Pinto etj...; pavarësisht se me vendimin presidencial në Tiranë, më 08. 03. 1994, Atë Bernardin Palajt i është dhënë, in memoriam, titulli "Mësues i Popullit" me motivacionin:

"Studiues i shquar i folklorit shqiptar. Autor i disa punimeve shkencore. Poet. Mësimdhënës. Edukator i palodhur i Gjimnazit "Illyricum". I vrrarë në burgjet komuniste nga torturat",

prapë se prapë, edhe mbas tridhjetë e tre viteve tranzicioni Atë Bernardin Palaj, ky martir shqiptar i shpallur i Lumë nga feja e krishterë, njohës i thellë i ADN - së sonë kulturore, ende nuk e ka mbërritur horizontin e pritjes të lexuesve të të gjitha moshave sepse:

Së pari. Nuk është bërë ende botimi i plotë i veprave të Bernardin Palajt, ku përmes receptimit nga lexuesit të shihen qartë vlera estetike që meritojnë përgëzim. Një punë e mirë ka nisur me daljen në dritë të opera omnia të autorit në poezi e poema origjinale, në folklor e folkloristikë dhe në etnografi e publicistikë, si pjesë e projektit për botimin e Kolanës së Shkrimtarëve Françeskanë, Shkodër.

Së dyti. Bernardin Palaj nuk është futur ende në programet shkollore në formë spiraleje ngjitëse, kur plot tetë dhjetë vite më parë ai zinte kryet e vendit tek libri antologjik "Bota shqiptare" për shkollat e mesme, nën kujdesin e pesëshes së artë të asaj kohe: Ernest Koliqi, Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Karl Gurakuqi, Kolë Kamsi, (Tiranë, 1943) dhe kur personaliteti i tij figuronte plot dinjitet te krestomacia dy gjuhëshe shqip - italisht "Studime e Tekste Juridike". Nr. 1", (Tiranë - Romë, 1944).

Së treti. Si rrjedhim shkrimtari nuk është vlerësuar ende si duhet, si klasik dhe modern njëherësh. Atë Bernardin Palaj nuk pranon asgjë spektakolare në rikthimin e tij denjësisht në letrat shqipe, mbasi e ka vendin e vet të merituar ku shfaqet si autor sërishmi i gjallë dhe imponues.

Atë Bernardin Palaj ishte një yll në plejadën e shkollës françeskanë, kryesuar nga Atë Gjergj Fishta, e cila bashkë me figurat vezulluese të shkollës jezuite, kryesuar nga Dom Ndre Mjeda, e ndritën kombin në fushat e letërsisë, të etnografisë, të folkloristikës, të filozofisë.

Hulumtimet për personalitete të veçanta poliedrike si Atë Bernardin Palaj, do të nxjerrin në pah të plotë shajninë e yllësisë së papërsëritshme të dy shkollave letrare të Shkodrës.

Kësisoj do të plotësohet "tabela e Mendelejevit" e letërsisë sonë, duke u renditur çdo element sipas "masës atomike" përkatëse.

REFERENCA:

- Aurel Plasari: "Palajt çka i takon Palajt". Gaz. "Drita". Tiranë 02. 04. 1995, f. 4.
- Alfred Çapaliku: Bernardin Palaj. Jeta dhe veprat. Monografi, Shkodër 1999, f. 3.
- P. Bernardin Palaj: "Mikpritja e Malevet". Rev. "Hylli i Dritës". Shkodër. Nr. 9 - 12 / 1943, fq. 348 - 349.
- Gjergj Fishta: Shih Ernest Koliqi. Kritikë dhe estetike. Tiranë 1999, f. 178.
- Ernest Koliqi: "Bernardin Palaj dhe një poemth i tij i pakryem". Kritikë dhe estetike. Tiranë 1999, f. 178.
- Angela Cirrincione: Bernardin Palaj. Opere. Volume I. Poesie. Roma 1969, p. 12.
- Arshi Pipa: "Communism and the Albanian Writers". Tek Gjon Sinisht. The Fulfilled Promise - a Documentary Account of Religious Persecution in Albania. Santa Clara 1976, p. 197 - 198.

Shkodër, 01. 07. 2024.



Karikatura nga Arben Meksi

PRISHJA

Nuk dihet nëse kjo legjendë është histori ndërtimi apo ndërtim historie.

1. Burrat e ndërtonin kështjellën ditën, u prishej natën. Natën edhe vetë burrat shemben: gratë u shtrojnë darkën i shtrijnë, u prishin palcën; kulla e burrërisë u shkrihet si orë e Dalisë, rrënohet e rërërohet... Vetë ato, gratë, e njohin shembjen nga brenda dhe nga brenga: çdo muaj krijuesi ua prish vezën si ajo kështjellë.

2. – Që kështjella të qëndrojë, – u tha plaku i huaj burrave, – duhet të murosni një grua, – e tha athua se po fliste për një material sekret të përçar brez pas brezi, ose si dikush që ua njuh pikën e dobët të pashpresëve – Do ta shihni që kështjella do të ngrihet e fortë.

3. Dielli ngrihej në majë. Gruaja me gjinjtë plot la birin, mori rrugën të ngjitej në majë kodre, ku kalaja e nisur qëndronte si thithkë.

Dhe nga të tria gratë i qëlloi gruaz që ngjizej të ishte materiali i shenjtë. Dy gratë shterpe, plaku, burrat, djali kërthi (sa shumë mashkullorësi!) qanë e vajtuan pranë murit gruan dhe jetimin, burrin dhe trashëgiminë.

Dhe vërtet, kështjella qëndroi. Fort. Rrënjët e botës-materiale ushqyer me lëndë njerëzore. (Plehu këtu kush është, kush ma thotë?)

Tekefundit ky nuk ishte sakrifikim gruaje, por shuarje race, prandaj bota sot vjen era vezë e prishur dhe avli.

ARTI DHE GRATË JANË FAJTORË TË MËDHENJ...

*May you climb a ladder to the stars
And climb on every rung
May you stay forever young...*
Bob Dylan

1. Arti nuk është më vepër. Është përhapur gjithandej. Poezia rri murosuri në raftet, në librari ngurtësuar si mbetje arkeologjike në pallat të ri. Metaforat u bënë popullore: reklamat i hodhën në treg. Një komentues futbolli bilbilos si poet. Dëgjoje! Si rapsod, a s'ta ngre zemrën peshë?! Flamur-ylber... ngjyrat piktori i ka për projekt. E bënë dhe artin të përdorshëm!!! Fundja, të rriturit këtë dinë të bëjnë me gjërat e çmuara: i zaptojnë. Le që, pse t'i gjykojmë?! Ndoshta është më i vlefshëm një Nobel që këndohet nën dush... Ja, nis e këndo!

2. Por kujt t'ia vë fajin për venitjen e shpresës përveçse atyre që kanë fuqinë të krijojnë?! Nga "Maria me Jezusin në krah" te "Zonja me kone" ka fare pak fëmijë në art dhe, rrjedhimisht, edhe në oborret, (të bësh fëmijë është kaq klasike!). Jo se s'janë interesantë, por kur gratë panë sesi ia përdorën bijtë për luftëra e bijat si fajtoresh filluan ta ekonomisin krijimin për të mësuar se jeta jepet për të qenë e hareshme... Tani njerëzit kanë krijuar çifte jo-bir-bërëse dhe bota është lehtuar, përnjëmend... Por arti dhe gratë janë fajtorë të mëdhenj...

3. Familja është bark. Ato dhe kishat zbrazen përditë mbesin si mitra të pabanuara grash, mitra shpejt do të harrohet si fjalë "epruvetë" është shumë më moderne dhe faji nuk mund t'i vihet i gjithi shkencës që në Barkën e Noes do të hipin veç kafshë, apo industrisë, që fabrikoji biberonë si gjinj,



ninulla në disk a përralla me zë, që shpiku nën-nënat me pagesë... Nga të dobëtit, kanë mbetur vetëm fëmijët.
Fundi i lumtur dhe gratë janë fajtorë të mëdhenj...

URI E SHUAR ME MOLLË

E shkuara, si largësia, ka ngjyrë tatuazhi atë grinë-në-blu të elefantëve-me-hapat-si-vulë, dhe duhet të jetë e ftohtë përderisa zogjtë shtegtarë të kujtimeve nuk kthehen më.

E zeza (si e tashmja) është potente, mbulon çdo ngjyrë tjetër, por tani kuptoj pse ime ëmë dezinfektonte me gëlqere: me këtë më edukonte që tek e ardhmja të shoh vetëm veten.

Pas të dyzetave një gruaje i vjen të rrijë mbi çati në pritje të kapë me sy të lirë dejtë e një vetëtime dhe të hidhërohet fill më pas, qyqe aty, kur qielli, si ëndrra, deje-deje ngrin, bëhet mermer mbi të cilin ndizet një qiri. Unë e ndez cigarin në flakë të qiririt e nuk di se cili prej të dyve bën më shumë dobi, por një zanore do ta lëshoja të gjatë, larg, gjer te një far, si tymi i tyre lajmërues, ngjyrë kalk.

Eh! Ka ca drita që nuk kanë dobi praktike,



por kanë temperaturën lokale të një dacke mbi fytyrë. Gruaja e di se dritat e bredhit lulëzojnë pak ditë, në të ritë, si apertiv, si Evë që me mollë e shuan urinë.

GJUHË E LEHTËSI

Hëna zgjedhohet si folje në kohën e qiellit e sonte qenka në formë urdhërore! Dita tulatet si fëmijë i dëgjuar me mjekrën te gjunjtë. Gjërat jashtë pakohen. Zërat mpaken. Perëndimi i përgjalptë fërgon peizazhin. Këngës mavi ia thotë zogu i natës. Në ekran të errësirës fillon e shfaqet një film pa titra. E unë jam po ajo, por me zanore më të zbehta. Përmjaltem pak si romanikët (a thjesht si kafshët) e tundohem të strehohem nën dikë, nën kafazin e kadifenjtë të sqetullës, brenda shtëpisë me grila, ku drita, si në kafaz hyn me feta imiton intimitetin e pyllit të lirë, ku fashat e rrezeve i bëjnë gjethet të flasin veç me mbaresa.

Hap derën. Shkreptin çelësi i dritës. E përhimet duket shtëpia me kaq shumë gjëra të përgatitura si sende diktimi. Sa pikëlluese është estetika e gjërave që kanë vend! Drita i vesh sendet me shkëlqim të bardhë që u përngjan reve të rreme pasqyruar mbi liqen dhe mu në mes, pritëse, e vetme, pa të mbyturin, ka mbetur varka: libri veshur me tanga - me fillin e kuq, ku si në tapet të kuq kalon ndarja.

Trishtimi mbetet më i rrepti mjet edukimi!

KUJTIMET

I dua dritaret me kanate si duar të hapura për përfaqim - të gjerë sa një oborr me lule. Mbështillem me krahët e mi për të ndier me mend praninë tënde. E shtrëngoq aq fort atë përfaqje çapitëse, sa ndjenjat plasnin si njolla të errëta në sy e zbresin si vesë mbi buzë te një puthje petali.

Hija e këtij vallëzimi në mur është njëjës, e hollë si një fyt i ngushtë për të marrë frymë kur lotët përmytin ajrin me avull, sytë dhe xhamat vishen me mjegull; në këtë dhomë të mbyllur si gonxhe banuar vetëm nga molat e kanateve që brejnë drurin në simfoni me molat e mia; unë e shoh qartë e thellë mallin prej mëndafshi; në këtë dhomë pa perde-petale-që-gëzohen-në-erë, ku endem si gjysmë tape mbetur brenda shishes përgjysmë me verë ndiej bulëza dhe bëj rrrathë të mpirë lëngjesh që përplasen prapë tek unë si një ishull lundruar; për t'u kalamendur në këtë vallëzim të përgjysmuar; psherëtim me rrokje – si puls – emrin tënd në vend të melodisë... Sa lehtë do ta mbanin peshën këta gjunjë të kapitur, kur faqet t'i puqnim pashqitshëm si mollëza gishtash të ngjyer në mjaltë!

Absurdi, si një tipar që mbizotëron dukshëm krijimtarinë prozaike të Buzatit, ndihet veçanërisht në tregimet e tij. Megjithatë, ishte kritika franceze e kohës, një shtysë e madhe në njohjen e letërsisë së tij, që analizoi se përkthimi dhe botimi në frëngjisht i romanit "Shkretëtira e Tartarëve", nxit edhe klasifikimin e këtij të fundit si *absurd*.

Kritiku francez Maurice Blanchote, mbi përkthimin e romanit në gjuhën franceze shprehet: "Një roman që shpejt duhet konsideruar si klasik. Një korrelacion fantastik mes dy fenomeneve, një vepër klasike mbi ekzistencializmin dhe absurdin e jetës, vdekjes dhe kohës midis. Por një vepër që gjallon vetëm përmes përkthimit."¹

Ndoshta duke lënë kështu të nënkuptuar dallimet në receptimin e romanit mes dy ambienteve letrare të ndryshme, siç ishte ai italian i kohës, dhe vendlindjes së dy rrymave të lartpërmendura, absurdizmit dhe ekzistencializmit, në Francë. Në letërsinë e Buzatit, dukshëm ndërthuren dikotomitë, bashkë si dhe mbivendosja e temave arketip si jetë-vdekja, rini-pleqëri, motivim-demotivim e të tjera. Në këtë bashkëjetesë të botës reale me atë fantastike dhe konkretes me absurdin, letërsia e Buzatit eksploron vdekjen, format dhe impaktin e saj. Kjo lidhje mes botës fantastike, po aq sa dhe absurde, reflektohet në dy tematika dikotomike mbizotëruese të letërsisë së tij: **absurdi dhe frika/ absurdi dhe vdekja**, dhe pikëtakimet me njëra-tjetrën (*vdekja si dënim dhe vdekja si shpëtim*). Nëse do të sprovonim skematizimin e absurdit, vdekjes dhe frikës në tregimtarinë e Buzatit, mund ta imagjinonim atë si një trekëndësh, ku në thyerje me traditën pararendëse, në kulmin e saj nuk do të vendosnim vdekjen, por *absurdin*, dhe në baza, *frikën* dhe *vdekjen*, duke parë se si të dyja varen prej fenomenit **absurd-izëm**.



Tregime si "Shembja e Balivernës" apo "E megjithatë po ju trokasim në derë", i ofrojnë lexuesit një shije të absurdit, por ndërtuar sipas një tjetër tradite letrare. Nga ana tjetër, tregime si "I vdekur gabimisht" shpërfaqin qartazi absurdin e jetës dhe

¹ <https://lareviewofbooks.org/article/translation-lets-you-change-your-mind-on-dino-buzzatis-the-stronghold/>

Mes vdekjes, frikës dhe absurdit në letërsinë e Dino Buzzati-t

Nga Jola Tasellari



ndoshta edhe parëndësinë, apo peshën e lehtë të saj. Një ditë të bukur, piktori italian, Lucio Predonzani, u shtang kur në mëngjes lexoi në gazetë shpalljen e vdekjes së vet. I alarmuar, i drejtohet redaksisë, nga ku i rekomandojnë se pavarësisht gabimit të shpalljes, të hiqet si i vdekur, që artit të tij t'i rritet vlera e shitjes. I shokuar se si pa u ndierë fare humbja e tij artificiale as dhe nga e shoqja, dhe me sa shpejtësi u zëvendësua, me qetësi e ftohtësi të frikshme shkoi në varreza, hapi arkivolin e tij dhe u mbyll aty pa pendesë.

Kjo seri vdekjesh e Lucios, e para absurde dhe gabimisht, dhe e dyta e vetë-kërkuar, na orientojnë drejt një linje tjetër tematike në letërsinë e Buzatit, ajo e raportit të **absurdit me vdekjen**. Këtu, fenomeni i vdekjes, jo vetëm i papërfillshëm e i mosvlerësuar, i trajtuar gati pa respekt, si pasojë e zhgënjimit, mosvlerësimit dhe ndjenjës së pakthyeshme të keqardhjes për veten, na ofrohet dhe si shpëtim, si çlirim nga bota: "Kur ende kishte mbetur pak hapësirë nga mbyllja e arkivolit, ngriti veshët të dëgjonte se mos e thërriste kush. Por jo, askush nuk e thirri. Atëherë e la të binte dhe kapaku i arkivolit iu mbyll plotësisht."

Absurdi në tregimet e Buzatit nuk shfaqet vetëm në rrethanat e ngjarjeve, apo si *absurdizëm*-absurdizmi klasik francez i shekullit të kaluar. Ai reflektohet në gjuhë dhe përdorimin e mjeteve stilistikore. Në tregimin "Vajza që bie" absurdi ndërtohet në qetësinë me të cilën përballen banorët e gradaçelës me një vajzë të re, që gradualisht, duke rënë nga kati i fundit në të parë, rrudhet e plaket. Gjuha e tregimit është e bukur dhe poetike; përshkrimet nuk zënë shumë vend, por sa herë bëhen, shtojnë idenë se Marta nuk po bie vërtet, por sikur po pluskon si një pendëz drejt tokës (*Apo*

mos po pluskon në kohë?). Në tregimin "Vajza që bie", Dino Buzzati krijon një rrëfim që kundërshton konvencionalitetin e reales, duke e shtyrë linjën e rrëfimit drejt absurditetit në raport me përvojën njerëzore. Normalizimi i rrethanave të jashtëzakonshme është një tjetër aspekt që gjallon absurdin në tregimtarinë e Buzatit, tipar ky që na shfaqet gjithashtu dhe në tregimet "Takimi i humbur", "Një rast interesant", apo dhe i një rasti tjetër klasik, "Shtatë katet", ku absurdi i këtij të fundit ndërtohet në rendin anti-kronologjik të hospitalizimeve, nga kati më i lartë, ku vendosen pacientët me simptoma të lehta, e deri në katin e parë, ku shtrohen ata me simptoma të rënda, me gjithë kalvarin disi tragjik të zbritjes së kateve, gati si një ferr dantesk. Pengesat absurde për të dalë, indiferenca ndaj rrethanave të çuditshme, mungesa e befasisë për irrealen dhe ndjenja e kotësisë shton masën e absurdit në rrëfim. Këtu, Dino Buzzati përdor elemente të absurdit për të krijuar një rrëfim surreal. Me evidentimin e kësaj triologjie tematike; *absurd, frikë, vdekje*, mund të mbërrijmë në konkluzionin se kemi të bëjmë me një tipar "bashkëjetues", pra, mundësinë e pranisë së njërit me kushtin e pranisë së tjetrit.

Kjo tematikë e vdekjes nuk ndryshon as në rrjedhën e rrëfimit *romanor* të Dino Buzatit. Në romanin "Shkretëtira e Tartarëve" mbizotëron tema e vdekjes, ekzistencializmit, dyshimit, absurdit, gati sikur të ishte shkëputur prej një teksti ekzistencialist francez, si për të provuar dhe një herë atë që kritika franceze thoshte në fillimet e botimit të romanit si fillim në Francë, se ky roman i flet ambientit kulturor francez shumë më tepër se atij italian. Vetëdija, që jehon sipërfaqësisht romanin, duket sikur gjallon vetëm nga dëshira për

të jetuar, luftuar përmbi një autoritet mbi unin individual.


E ndërtuar përmbi absurdin e pritjes së pafundme dhe një padije mbi të, romani shpërfaq imtësinë e kalimit të jetës njerëzore nga dëshira tek nevoja, mandej frika e në fund vdekja. Gjuha gati sugjestionuese, na shtyn të mendojmë një fund të errët e të sigurt, sikur personazhet pashmangshmërisht gravitojnë drejt fatit të vet, ndoshta të pavetëdijshëm se nuk ka më kthim pas. Tanimë, me këtë frymë të re, ndryshe nga triada tematike e tregimeve, nuk është më frika ajo që na përplotëson trekëndëshin me **absurdin** dhe **vdekjen**, por është **koha**. Koha, me likuiditetin e saj ka arritur të sheshojë nevojën dhe rëndësinë e individit në jetën e të tjerëve që la pas. Tanimë, jeta ka mbetur një udhëtim linear i panjohur, nga Fortesa deri në destinacionin e fundit, vdekjen.

Romani "Shkretëtira e Tartarëve" nga ana tjetër e kornizon absurdin së pari në anticipimin e pritjes: Xhiovani Drogo, është vendosur në fortesë duke pritur një pushtim hipotetik prej tartarëve. Megjithatë, pushtimi nuk ndodh kurrë dhe ai i kalon vitet më të mira të jetës së tij duke pritur për një ngjarje që duket gjithnjë e më e pamundur. Absurditeti gjallon në pritjen dhe kotësinë e saj, pa kurrfarë sulmi në sfond.

Në "Shkretëtirën e Tartarëve", Buzati i bashkon me mjeshtëri këto tema së bashku, duke eksploruar gjendjen njerëzore, absurditetin e ekzistencës dhe pashmangshmërinë e vdekjes në një botë që shfaqet krejt indiferente ndaj kësaj. Po ashtu si dhe në tregimet e tij, për shkak të emigrimit ideor të autorit nga një formë e prozës në tjetrën, absurdi, frika dhe vdekja ngrihen në nivele të ekzistencializmit, duke sprovuar një zhanër të ri në ambientin letrar italian, dhe që e ngrënë autorin në nivele të një shkrimtari botëror.

Referenca dhe bibliografi

- Los Angeles Book Review Magazine, 2023.
Tufa, Agron, *Letërsia dhe procesi letrar në shekullin e XX-të*, Botimet M&B, Tiranë, 2018.
Buzzati, D. (2018). *Catastrophe*, Harper Collins, 2018.
Buzzati, Dino, *Shkretëtira e Tartarëve*, Ombra GVG, Tiranë, 2021.
Buzzati, Dino, *Kryeveprat*, Ombra GVG, Tiranë, 2010.



POETI I VUEJTUN BARBUN

(nga Historia e Poezisë Shqipe)

Tregim nga Ylli Pango

Poeti i vuajtur, fliste me një zë...me një zë... sado të trashë...aq edhe të dridhur, të pasigurt...ligjërata i rridhte jo si pena, shpenguar...por siç do thoshte vetë, "si ujë i turbulluar përroi...ngecur nëpër gurë të mëdhenj e të vegjël..." herë i humbte e herë i dilte zëri...veç po ti vije vesh...të kishe vesh...i gjeje gurgullimë, i gjeje melodi...

...poeti spiun fliste e fliste...edhe flet qashtë,kulluar ...vargu i tij vjen nga rezervuari e rrjedh direkt në rubineta, zemrash...ujë i mbajtur pastër e kulluar...me shumë kujdes...me filtra e trajtim kimik...purifikues...zbutës(kini dëgjuar besoj zbutës uji)

...Poeti i vuajtur vazhdon të trajtohet, vettrajtohet varfër, ushqehet keq...pi raki të keqe, të lirë në zgëq(ngushëllohet me thënien e kryepoetit pijetar: " nuk ka raki të keqe...) ...gjithsesi poeti i vujtun pret kurdoherë ta ftojë dikur...diku... ndonjëherë...herë herë...ti japin një gotë raki, vërtet raki...

...Poeti spiun(spy-poet), jeton në një shtëpizë të ëmbël poetike, mes kodrash të buta...thotë se e ka bërë me paratë e librave...sidomos të librit " Armiqtë e nanës..." " ai libër" i thotë një miku " m'ka dhanë shumë pare..."

...poeti-spy, pi verë të mirë... ushqehet edhe në shtëpi, por sidomos ftohet të pihet e ushqehet...në restorante me emër si,Forum, Paladium, Podium...

...Poeti i vuajtur dikur foli a shkroi diçka,sikur protestoi a sikur u ankua, (më shumë u trishtua) për poetin e pataleutuar-spiun ...diçka si... "gjithmonë këta...nuk u ngopën...pa talent..."

...pastaj heshti...se edhe pak e lexuan... ca pak e "like"-n...më të shumtët s'e vunë re...a bënë sikur s'e vunë re...çne melazëm... ta prishnin me ...poetin-spiun... me poetin me pozitë Barbun...

...Poeti spiun e mori çmimin e parë, ja bënë dhuratë diku...

...Aty në atë aktivitet me ceremoni, blatur poetit Barbun, i ftua e shkoi dhe poeti i vuajtur...

...Vajti po nuk foli... nuk foli fare...u struk në karriken e shtate te rrjeshtit në fund...e pastaj kur zulma mbaroi... që andej, si me turp, si anash e anash...mbririti së fundmi pranë tryezave të kokteit, të pijeve, mezeçkave të vogla...s'e fshihte dot... I pihje...

...Aty poeti i vujtun, u zbut, u zbrujt, u lag...u bë i gjithi këmishë e bërë qullë...

...dhe u zbërthye pak aty...poeti i vujtun...piu një gotë raki aty...dy, i dhanë dhe një të tretë ...dhe qau...por as aty, as-as...si edhe në mexhlisin poetik...nuk tha gjë për çmimet, për kultet, për poezinë e vet, e për atë të poetëve spiunë, për klanet e trofetë mes vedi...ishite i mallëngjyer, tru i zbutur, në avuj alkooli...i donte, njerëzit poeti... ndjeu se i donte të gjithë aty përreth...kolegët poetë...edhe poetin spiun... bashkë me ta...të gjithë skotën e palodhur, e pambaruar të poetëve spiunë...

...Natyrshtëm: poetët e vujtun janë humanë...e duan njeriun...me gjithë mëkatet...e si mund të jesh poet pa mëkatet" mendoi dhe piu edhe ca...

...Poeti spiun as që e e vuri re poetin e vujtun, që ishte...a s'ishite atje... ose dhe e vuri re...e bëri sikur s'e vuri re...e as bëri sikur u kujtua që ai i pat shkruar ca fjalë, që i patën raportuar se i pat shkruar ca fjalë...për talentin... jo-talentin e tij...

...pas do kohesh ju blatura diku, një çmim tjetër...një tjetër poeti-spiun, ...por aty poeti i vujtun nuk mori pjesë, ndonjëse e patën ftuar...pa e ditur kush...se poeti i vujtun... pat vdekun.



Tomas Tranströmer

SHUBERTIANA

Përktheu nga origjinali Qerim Raqi

I

Në errësirën e mbrëmjes në një vend jashtë New Yorkut, një pikë vrojtimi ku njeriu me një shikim mund të kap shtëpitë e tetë milionë njerëzve.

Qyteti gjigant atje larg është një breg i gjatë vezullues bore një galaks spirale nga njëra anë.

Në brendi të galaksit udhëtojnë filxhanat mbi enët, dritaret e reklamave lypin nga kalimtarët, mizëri këpucësh që nuk lënë asnjë gjurmë.

Shkallë emergjente zjarri, dyer ashensorësh që njëjtësohen me dyert e kyçura me dryrë të policëve, një dallgë e vazhdueshme zërash.

Trupa të pashpresë që dremisin vagonave të metrove, katakombe shumë të shpejta.

Unë e di gjithashtu - pa ndonjë statistikë - se pikërisht tani luhet Shuberti në njëren nga dhomat atje dhe se ata tinguj për dikë janë më realë se gjithçka tjetër.

II

Hapësira e pakufishme e trurit të njeriut është tkurrur në madhësinë e një grushti të dorës.

Në prill kthehet dallëndyshja në folenë e vjetshme në zgavrën e çatisë mu në këtë ahur mu në këtë famulli. Fluturon nga Transilvania, kalon Ekuadorin, për gjashtë muaj fluturon mbi dy kontinente, drejtohet mu kah kjo pikë zhdukjeje e këtij kontinenti.

Dhe ai që i kapë sinjalet e një jete të tërë ca akorde mjaft të zakonshme të pesë harqeve ai që bënë lumin të rrjedhë nëpër një vrimë gjilpëre është një burrë i ri, i shëndoshë nga Viena, që shokët e quanin.

"Kërpudha" që flinte me syze ulet me elegancë pranë tavolinës së shkrimit mëngjesëve.

Duke i vënë në lëvizje njëmijëkëmbëshat e mrekullueshëm të kompozimit.

III

Të pesë violinat luajnë. Unë shkoj në shtëpi nëpër ca pyje ngazëllyes nëpër tokën që vibron nën mua tkurret si një i posalindur, fle rrotullohet pa peshë brenda ardhmërisë, ndjeje befas që bimët kanë mendime.

IV

Sa shumë na duhet të besojmë për ta jetuar të përditshmen ditë pa zbritur në tokë!

T'u besojmë ortiqeve të borës që ngjiten majeve të shkëmbit mbi fshat.

T'u besojmë premtimeve të heshtjes dhe buzëqeshjes së mirëkuptimit, të besojmë se telegramet e fatkeqësive nuk na përkasin dhe se goditja befas e brendëshme me sëpatë nuk do të vijë.

T'u besojmë si vetes boshteve të rrotave rrugëve mu në mes të mizërisë së treqindfishuar prej çeliku

Por asnjëra nga këto nuk e meriton besimin tonë.

Pesë violinat na thonë që ne mund të besojmë në diçka tjetër.

Në çka? Në diçka tjetër, dhe ato na përcjellin paksa deri aty. Sikur fiket drita tek shkallët dhe dorën e vëmë pas - me vetbesim - pamakut të verbër urdhërrëfyes që e njeh errësirën.

V

Ne rrinim ngjeshur pranë pianos duke luajtur me katër duarnë f-mol, dy kalorës në të njëjtin karrocë dukej paksa qesharake.

Dukej sikur duart tona zhvendosnin peshat e tingujve andej-këndej, sikur lëvizinin kundërpeshat në përpjekje për ta prishur drejtpeshimin e tmerrshëm të krahëve të peshores: gëzimi dhe vuajtja peshojnë njësoj.

Annie tha: "kjo muzikë është shumë heroike", dhe kjo është e vërtetë.

Por ai që shikon me mëri burrat e ngjarjes, ata që në brendinë e tyre urrejnë veten që nuk janë vrasësata nuk e gjejnë veten këtu.

Dhe një pjesë e madhe e atyre që blejnë e shesin njerëz dhe mendojnë se të gjithë mund të blihen, ata nuk e gjejnë veten këtu.

Nuk është muzika e tyre. Melodia e gjatë që është vetvetja në të gjitha metamorfozat, nganjëherë shkëlqyese dhe e dobët, ndonjëherë e vrazhdë dhe e fuqishme, gjurmë kërmilli dhe fije çeliku.

Gumëzhitja kryeneçe që na shoqëron mu tani nga lart në thellësi.



Shtëpia Botuese Onufri ju fton
në promovimin e librit

“Porosia e kullës”

nga

PASHKO R. CAMAJ

E enjte, 17 tetor | Ora 11:00

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Salla “Aleks Buda”


E premte, 18 tetor | Ora 12:00

Instituti Albanologjik, Prishtinë

E shtunë, 19 tetor | Ora 18:00

Qendra Informativo-Kulturore “Malësia”, Tuz

Onufri



Kështu, *Porosia e kullës*, njëherësh *Ëndërrime nga bagazhi i një vature amerikane*, është pikërisht përshkrimi i rrugëtimit të brendshëm, domethënë shpirtëror, por edhe atij të jashtëm, domethënë social, që Pashko R. Camaj ka kryer deri më sot për të njohur veten. Është një rrugëtim që vazhdon. Vetë protagonist-autor, me mënyrën si e sheh horizontin, drejt të cilit përparon, na lë qartë të kuptojmë ne, si lexues, se ai jo thjesht për arsye të moshës, por më së pari për arsye të filozofisë udhëheqëse për jetën e vet, nuk e sheh aspak të përmbyllur as rrugëtimin e vet të brendshëm, atë shpirtëror dhe as rrugëtimin e jashtëm, atë social. Një vetëdije e tillë frymëzon energji të mëdha shpirtërore, besim të madh në vete e në mjedisin shoqëror përreth, optimizëm po aq të madh dhe vullnet të fortë për të luftuar vetëkënaqësinë, duke synuar pareshtur për të dhënë më të mirën e vet.

BESNIK MUSTAJ
(Fragment nga parathënia)

Pashko R. Camaj ka lindur në vitin 1964 në Mal të Zi, ku përfundoi arsimin e mesëm dhe shërbimin e detyrueshëm ushtarak para se të emigronte, nëpërmjet Meksikës, në Shtetet e Bashkuara, në vitin 1985. Disa vite më vonë, në moshën njëzetetëvjeçare, ai u pranua në City University of New York, ku përfundoi studimet bachelor dhe master për shkencat e mjedisit dhe të shëndetit në punë. Në vitin 2013, në moshën dyzetëntëvjeçare, ai mbrojti tezën e doktoraturës dhe mori gradën Doktor i Shëndetit Publik në Universitetin e Kolumbias në Nju-Jork.

Pashku ka botuar disa studime akademike të vlerësuara në fushën e shëndetit publik dhe kjo është vepra e tij e parë e këtij lloji. Aktualisht, ai shërben si anëtar i udhëheqjes së lartë për “MTA- Bridges&Tunnels”, një agjenci shtetërore transporti në Nju-Jork dhe është gjithashtu një ndihmësprofesor në Universitetin “William Paterson” në Nju Xhersi.

Përveç kësaj, Pashku aktualisht shërben si sekretar i Federatës Panshqiptare të Amerikës “Vatra”, organizata më e vjetër amerikano-shqiptare në Shtetet e Bashkuara.